KRYEMINISTRIA E SHQIPËRISË
Hyrje Nr. 6236 Prot.
Dt. 21.07.2008
Daljo Dt. ____.____.200_

KONTRATË KONÇESIONI
PËR
PRODHIMIN DHE SHPËRNDARJEN E KARTAVE TË IDENTITETIT DHE PASAPORTAVE ELEKTRONIKE

Ndërmjet

MINISTRISË SË BRENDSHME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Dhe

GRUPIMIT TË SAGEM SÉCURITÉ DHE FONDIT SHQIPTARO – AMERIKAN TË NDËRMARRJEVE

Tiranë, 21 Korrik 2008

Përmbajtja

Nr.	Titulli Nenet	Faqja
1.	Përkufizimet dhe interpretimi	7
2.	Kujdesi i duhur	8
3.	Dhënia e Koncesionit	9
4.	Data Efektive e kësaj Marrëveshje	16
5.	Plan i projektit	15
6.	Prova	15
7.	Vonesat në zbatim - Dispozita të Përgjithshme	18
8.	Vonesat për shkak të Pazotësisë së Koncesionerit	17
9.	Vonesat në arritjen e Pikësynimeve për shkaqe të Autoritetit	18
10.	Shërbimet	19
11.	Nivelet e Shërbimeve	21
12.	Rrjedhoja e Shkaqeve të Autoritetit në fazën Operacionale	22
13.	Standartet	23
14.	Siguria dhe vëzhgimi i cilësisë	23
15.	Përmirësimi i Shërbimeve	23
16.	Sistemi	26
17.	Çështje financiare	25
18.	Taksat	26
19.	Përfaqësuesit	29
20.	Rregullimi	27
21.	Nën - kontraktimi	27
22.	Rishikimi i Shërbimit	28

23. Kontrollet financiare 28

24. Rregjistrat dhe raportet 30

25. Kontrolli i ndryshimit 30

26. Personeli 32

27. Detyrimet e marra përsipër nga Sagem dhe Albanian - American Enterprise Fund / Fondit Shqiptaro - Amerikan të Ndërmarrjeve AAEF 31

28. Mirëmbajtja 32

29. Shëndeti dhe siguria 32

30. Barazia dhe ndryshueshmëria 32

31. Të drejtat e pronësisë intelektuale IPR-të 33

32. Lejet e dhëna nga Koncesioneri 33

33. Lejet e dhëna nga Autoriteti 33

34. Rregullimi i IPR-ve në Bazat e të dhënave 34

35. Rregullimi i IPR-ve të Posaçme të Projektit dhe i Programeve Kompjuterike të Përgatitura Posaçërisht 35

36. Të dhënat e Autoritetit 35

37. Mbrojtja e të Dhënave Personale 36

38. Detyrime të Posaçme të Autoritetit 38

39. Detyrime të Përgjithshme të Autoritetit 40

40. Plani i daljes nga gjendja e dëmtimeve të rënda 42

41. Forca madhore / *Force Majeure* 40

42. Dëmshpërblimet 40

43. Konfidencialiteti 43

44. Kufizimet mbi përgjegjësinë 44

45. Sigurimi 49

46. Burimi, Liçenca, Detyrimet për Bashkëpunim të Koncesionerit 50

47.	Garancitë	46
48.	Siguria	53
49.	Të drejtat dhe detyrimet e Koncesionerit	51
50.	Mbarimi	53
51.	Pasojat e Mbarimit	59
52.	Menaxhimi i daljes	55
53.	Të drejtat për ndërhyrje	56
54.	Lidhja e përmbushjes	58
55.	Caktimet	59
56.	Çlirimi dhe Kompensimet përmbledhëse	60
57.	Marrëdhënia e Palëve	60
58.	Parandalimi i Korrupsionit	60
59.	Publiciteti dhe vendosja e markës	61
60.	Ndarja	61
61.	Sigurime të mëtejshme	61
62.	Marrëveshja si një e tërë	61
63.	Të Drejtat e Palëve të Treta	62
64.	Njoftimet	62
65.	Gjuha	62
66.	Ligji rregullues dhe Juridiksioni	63

PROGRAMET

Programi 1	Përkufizimet
Programi 2	Kërkesat e Autoritetit (Dokumentat e tenderit të publikuara më 25 janar 2008)
Programi 3	Zgjidhja e Koncesionerit (Oferta e Grupimit / Konsorciumit e datës 1 shkurt 2008)
Programi 4	Lista e përmirësimeve të rëna dakord në Programet 2 dhe 3 (Dokumentat e tenderit)
Programi 5	Nivelet e Shërbimit
Programi 6	Plani i provës
Programi 7	Sigurimi
Programi 8	Detyrime shtesë të Autoritetit
Programi 9	Nën – kontraktorët e miratuar
Programi 10	Plani i Projektit
Programi 11	Çështje financiare
Programi 12	Lidhja e përmbushjes
Programi 13	Personeli kyç
Programi 14	Çertifikata e pranimit të dorëzimit dhe të kthimit
Programi 15	Zgjidhja e konflikteve
Programi 16	Proçedura për kontrollin e ndryshimit

KJO MARRËVESHJE bëhet më 21 korrik 2008 në Tiranë, Shqipëri

NDËRMJET:

Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë (në vazhdim referuar si **"Autoriteti")** e caktuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 525, datë 8.8.2007 "Mbi identifikimin e Projektit të Koncesionit "Prodhimi dhe lëshimi i kartave të identitetit dhe pasaportave elektronike" dhe përcaktimin e Autoritetit", përfaqësuar nga Ministri i Brendshëm Z. **Bujar Nishani**.

DHE

Grupit të shoqërive me ortakë si vijon:

Sagem Sécurité, një shoqëri anonime («société anonyme») me një kapital prej 159 876 075 Euro, rregjistruar në Regjistrin e Tregtisë dhe të Shoqërive në Paris me numrin 440 305 282, zyra e regjistruar e së cilës gjendet në adresën 27, rue Leblanc, 75015 Paris, Përfaqësuar nga Z. Jean-Paul Jainsky, i autorizuar në mënyrën e duhur për qëllimet e këtushme në cilësinë e tij si Kryetar dhe CEO,

Dhe

Fondi Shqiptaro - Amerikan i Ndërmarrjeve, një shoqëri jo fitimprurëse e rregulluar nga ligjet e Shtetit Delaware në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, zyra e regjistruar e së cilës gjendet në adresën 14 East 60th Street, Suite 407, New York, NY 10022 USA, dhe që ka një zyrë përfaqësimi në adresën Rr. "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Kompleksi Green Park, Kulla 2, Kati 11, Kutia Postare 1731, Tiranë, Shqipëri, e që përfaqësohet nga Z. **Aleksandër Carapuli** dhe Z. **Martin Meta**, të autorizuar në mënyrën e duhur për qëllimet e këtushme.

Në vazhdim Grupi i lartpërmendur referohet si **"Koncesioneri"**;

DEKLARIME PARAPRAKE

Në përputhje me sa vijon:

- Ligjin Nr. 9663, datë 18.12.2006 "*Mbi koncesionet*";
- Ligjin Nr. 8952, datë 10.10.2002 "*Mbi lëshimin e pasaportave për shtetasit shqiptarë*";
- Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 541, datë 26.07.2006, "*Mbi miratimin e formatit të pasaportave dhe përmirësimin e sistemit përkatës të lëshimit*";
- Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 27, datë 19.1.2007 "*Mbi miratimin e kritereve të vlerësimit në lidhje me dhënien e koncesioneve*";

- Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 253, datë 27.04.2007 *"Mbi përcaktimin e elementëve të sigurisë, formës dhe formatit në lidhje me dokumentat e identitetit të shtetasve shqiptarë"*;

- Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 715 datë 06.11.2007 "Mbi disa ndryshime në VKM Nr. 253, datë 27.04.2007, "*Mbi përcaktimin e elementëve të sigurisë, formës dhe formatit në lidhje me dokumentat e identitetit të shtetasve shqiptarë*";

- Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 196, datë 13.04.2007, "*Mbi miratimin e Koncesionit, prodhimit dhe shpërndarjes së dokumentave të identitetit dhe pasaportave elektronike për shtetasit shqiptarë*";

- Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 525, datë 08.08.2007 "*Mbi shpërndarjen e dokumentave të identitetit dhe pasaportave elektronike*";

Autoriteti është i autorizuar që të arrijë këtë Marrëveshje;

NDËRSA

(A) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë ka identifikuar përmes Vendimit Nr. 525, datë 08.08.2007 projektin për Koncesionin "Mbi prodhimin dhe shpërndarjen e dokumentave të identitetit dhe pasaportave elektronike", dhe ka përcaktuar Ministrinë e Brendshme si Autoriteti;

(B) Autoriteti ka lëshuar më 25.01.2008 Dokumentat e Procedurës së Konkurrimit për dhënien e Koncesionit "Mbi prodhimin dhe shpërndarjen e dokumentave të identitetit dhe pasaportave elektronike", këtu bashkangjitur si Programi 2 i kësaj Marrëveshje;

(C) Koncesioneri ka paraqitur më 28.02.2008 një propozim në përgjigje të një tenderi të tillë në lidhje me Koncesionin "Mbi prodhimin dhe shpërndarjen e dokumentave të identitetit dhe pasaportave elektronike", këtu bashkangjitur si Programi 3 i kësaj Marrëveshje, propozim i cili është pranuar nga Autoriteti;

(D) Autoriteti i ka dërguar Koncesionerit më 09.05.2008 "Njoftimin e Fituesit", (Dokumenti Nr. 3564) duke pranuar propozimin e paraqitur nga Koncesioneri dhe duke caktuar këtë koncesion ndaj këtij Koncesioneri;

(E) Autoriteti dhe Koncesioneri përfshihen në këtë Marrëveshje me qëllimin për të vënë në jetë koncesionin në përputhje me afatet dhe dispozitat e përcaktuara në këtë Marrëveshje;

(F) Koncesioneri, brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshje do të caktojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (në vazhdim "Shoqëria Koncesionere"), e cila, përveçse për sa i përket Neneve 27 dhe 28, do të jetë e caktuara me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Koncesionerit sipas kësaj Marrëveshje të tanishme Koncesioni;

(G) Palët njohin faktin që ky projekt dhe dhënia e Koncesionit është e një rëndësie kritike kombëtare dhe se afatet kohore për lëshimin e dokumentave të identitetit duke përdorur sistemin e ri janë themelore. Palët njohin faktin që plotësimi në kohë dhe në mënyrën e duhur nga ana e tyre i detyrimeve që ato kanë dhe bashkëpunimi e ndihmesa më e gjerë me Palën tjetër siç përcaktohet me hollësi në këtë Marrëveshje është thelbësorë për vënien në jetë të projektit.

DISPOZITA OPERATIVE:

1. Përkufizimet dhe interpretimi

1.1 Në këtë Marrëveshje, do të zbatohen përkufizimet e paraqitura në Programin 1 (**Përkufizime**).

1.2 Në këtë Marrëveshje, përveçse kur konteksti kërkon ndryshe:

1.2.1 Njëjësi e përfshin shumësin dhe anasjelltas;

1.2.2 Referimi tek njëra gjini përfshin edhe gjininë tjetër dhe gjininë neutrale;

1.2.3 Referimi tek një akt i Parlamentit, dispozitë statutore apo instrument statutor përfshin referimin tek ai akt i Parlamentit, dispozitë statutore apo instrument statusor siç është ndryshuar, zgjeruar apo rimiratuar kohë pas kohe dhe tek çdo rregullore e nxjerrë sipas tij. Pasoja e çfarëdo ndryshimi, zgjerimi apo rimiratimi të tillë mbi këtë Marrëveshje do të zgjidhet në përputhje me Nenin 25 (Kontrolli i ndryshimit);

1.2.4 Çdo frazë që fillon me fjalët "duke përfshirë", "përfshin", "në veçanti", "për shembull" apo të ngjashme, do të kuptohen si ilustruese dhe pa kufizim ndaj përgjithshmërisë së fjalëve të përgjithshme të lidhura;

1.2.5 Referimet tek një person përfshijnë një shoqëri, korporatë dhe shoqatë apo autoritet ligjor të pakorporuar apo të bashkuar;

1.2.6 Titujt e përdorur për nenet, paragrafët, nënparagrafët, Programet dhe tabela e përmbajtjes janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojnë interpretimin e kësaj Marrëveshje;

1.2.7 Referimet tek çdo marrëveshje ose intrument janë për atë marrëveshje ose instrument siç janë ndryshuar, risuar, shtuar, modifikuar ose zëvendësuar kohë pas kohe; dhe

1.2.8 Një referim tek secili organ është:

(i) Nëse ai organ zëvendësohet nga një organizëm tjetër, vlerësohet se i referohet asaj organizate; dhe

(ii) Nëse ai organ pushon së ekzistuari, vlerësohet se i referohet organizatës që më afër ose në shkallën më të madhe shërben për të njëjtat qëllime ose objekte sikurse ai organ.

1.3 Titujt në këtë Marrëveshje janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojnë në interpretim.

1.4 Referimet në dispozitat dhe Programet janë, përveç rastit kur parashikohet ndryshe, referime tek dispozitat e dhe programet e kësaj Marrëveshjeje.

1.5 Pa paragjykim ndaj Nenit 10.4.4, nëse ka ndonjë konflikt ndërmjet dispozitave dhe Programeve dhe/ose ndonjë shtojce të Programeve dhe/ose çdo dokument tjetër që i referohemi në këtë Marrëveshje, konflikti do të zgjidhet në përputhje me rendin e mëposhtëm të preçedencës:

1.5.1 Nenet dhe Programi 1 (**Përkufizime**);

1.5.2 Programi 2 (**Kërkesat e Autoritetit**);

1.5.3 Programi 5 (Nivelet e Shërbimit);

1.5.4 Programi 4 (Lista e ndryshimeve të rëna dakord ndaj Programit 2 (Kërkesat e Autoritetit) dhe Programi 3 (Zgjidhja e Konçesionerit));

Nëse një përmirësim apo sqarim nuk deklarohet në këtë Program 4 (Lista e ndryshimeve të rëna dakord ndaj Programit 2 (Kërkesat e Autoritetit) dhe Programi 3 (Përfundimet Zgjidhja e Konçesionerit)) atëherë në të gjitha situatat do të ketë përparësi Programi 2 si deklarimi thelbësor i Kërkesave të Autoritetit që duhet të përmbushë Konçesioneri;

1.5.5 Programi 3 (Zgjidhja e Konçesionerit);

1.5.6 Programi 11 (Çështje financiare);

1.5.7 çdo Program tjetër dhe shtojcat e tyre; dhe

1.5.8 çdo dokument tjetër që i referohemi në këtë Marrëveshje ose çdo dokument tjetër bashkangjitur më këtë Marrëveshje.

1.6 Duke ju nënshtruar dispozitave të Neneve 6 deri në 9 (përfshirë), asnjë Palë e kësaj Marrëveshjeje nuk do të jetë përgjegjëse për Pazotësinë e detyrimeve të saj bazuar në këtë Marrëveshje deri në masën që kjo Pazotësi është shkaktuar nga një dështim ose vonesë nga Pala tjetër në realizimin e detyrimeve të saj bazuar në këtë Marrëveshje. Pala e prekur do të njoftojë Palën tjetër për një dështim apo vonesë të tillë brenda 30 ditëve që Pala e prekur bëhet e vetëdijshme për këtë ngjarje dhe efektin e saj të mundshëm.

2. **Kujdesi i duhur**

2.1 Konçesioneri njeh që:

2.1.1 ka bërë dhe do të bëjë kërkimet e veta për të gjitha çështjet përkatëse për zbatimin dhe përmbushjen e detyrimeve të tij bazuar në këtë Marrëveshje, duke përfshirë kërkimin e informacionit të tillë nga Autoriteti pasi Koncesioneri beson se kërkohet për një qëllim të tillë;

2.1.2 ka ngritur të gjitha çështjet e arsyeshme mbi kujdesin e duhur përpara Autoritetit përpara Datës Efektive;

2.1.3 është ndërgjegjësuar përsa i përket përmbajtjes dhe kërkesave të Politikave të Autoritetit të referuara në Programet 2 (Kërkesat e Autoritetit) dhe 3 (Zgjidhja e Koncesionerit); dhe

2.1.4 ka të gjithë njohurinë, të drejtat, pajisjet, programet kompjuterike, sistemet dhe personelin e nevojshëm me qëllim që t'i japë mundësi atij të zbatojë detyrimet që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, duke përfshirë mundësinë për të përmbushur dhe realizuar kërkesat e Zgjidhjes së Koncesionerit.

2.2 Autoriteti garanton që të gjitha të dhënat e vëna në dispozicion të Koncesionerit me shkrim janë të sakta, të përpikta dhe të vërteta, duke përfshirë këtu Dokumentat e Tenderit.

3. Dhënia e Koncesionit

3.1 Dhënia e Koncesionit

3.1.1 Duke ju nënshtruar dhe në përputhje më afatet dhe kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe Programet bashkangjitur, Autoriteti jep dhe autorizon Koncesionerin të zbatojë shërbimet e hartimit, përcaktimit, zhvillimit, zbatimit dhe operimit të Sistemit, për furnizimin me Dokumenta identifikimi të shtetasve dhe/ose rezidentëve të Republikës së Shqipërisë.

3.1.2 Koncesioneri do të sigurojë shërbimin e hartimit, përcaktimit, zhvillimit, zbatimit dhe operimit të Sistemit i cili do të drejtohet përmes nënsistemeve të mëposhtme:

(i) Nënsistemi i Aplikimeve dhe Regjistrimit

- regjistrimi i të Dhënave të Gjendjes Civile të Aplikantëve;
- regjistrimi i të Dhënave Biometrike të Aplikantëve;
- sigurojë transmetimin e të dhënave (on-line ose off-line) brenda në dhe nga Faqja Qëndrore e Personalizimit, Ndërtimin e Mbështetjes (Back-Up) dhe Zyrat Administrative Rajonale;
- Proçesin e aplikimit për rinovimin e Dokumentave të identitetit;
- Dorëzimin e Dokumentave të identitetit tek secili Aplikant;

(ii) Nënsistemi i të Dhënave Biometrike

- Dixhitalizimi i formularëve të mbledhur të Aplikimit dhe dokumentave mbështetëse/plotësuese;

- Hyrja dhe ruajtja e të Dhënave Biometrike në Faqen Qëndrore të Personalizuar dhe Ndërtimin e Mbështetjes (Back Up);
- Verifikimet e shenjave të gishtave të regjistruar kundrejt të dhënave të ruajtura të shenjave të gishtave (1:n kërkimi për identifikim);
- Verifikimet e Aplikimeve kundrejt regjistrave të jashtëm kur është e mundur në varësi të proçesit të biznesit (Regjistri Kombëtar i Shtetasve, Regjistri i Policisë dhe Sistemi Automatik i Shenjave të Gishtave të Policisë (AFIS).

(iii) Nënsistemi i Kontrollit të Cilësisë, Materialit, transportimit, dhe Përdorimi

- Kontrolli i cilësisë, transportimi dhe përdorimi i të Dhënave Biometrike dhe Gjendjes Civile të Aplikantëve;
- Trajtimi i Dokumentave të identitetit të vjedhura ose të humbura;
- Mbështetja dhe ndihma për përdoruesit e Sistemit dhe shërbimet e Bankës Ndihmëse;
- Transporti i Dokumentave të identitetit dhe dokumentave të tjerë që lidhen me to, formularët e aplikimit dhe ruajtja e materialeve në faqet/mjediset e këtij Konçesioni.

(iv) Nënsistemi i Personalizimit

- Personalizimi grafik dhe elektronik i Dokumentave të identitetit,
- Kontrolli i cilësisë së Dokumentave të identitetit të prodhuara (personalizuara),
- Administrimi i inventarit të Artikujve, dokumentave të dëmtuar Dokumentave të identitetit të personalizuar, arkivin fizik të formave të aplikimit, etj.

(v) Nënsistemi i Infrastrukturës së Autoritetit të Çertifikuar:

- Lëshimi dhe shpërndarja e çertifikatave elektronike që lidhen me Dokumentat të identitetit të Aplikantëve;
- Administrimi i çertifikatave elektronike të Aplikantëve (vlefshmëria, lista e revokuar);
- Menaxhimi i PKI.

Ky nënsistem mund të skicohet pasi më parë të jetë përcaktuar Autoriteti i Çertifikimit të Vendit Origjinë nga Qeveria e Shqipërisë. Çertifikatat e lëshuara të vendit do të përdoren nga Konçesioneri për të arritur skemën e lartpërmendur.

3.1.3 Për më tepër, për qëllimin e sigurimit të shërbimeve të përshkruara më lart, objekti i kësaj Marrëveshje do të përfshijë gjithashtu:

(i) përcaktimin nga Konçesioneri të një Vendi Qëndror të Personalizimit të vendosur në "Topografinë Ushtarake"të dikurshme në Tiranë përmes rindërtimit fizik, rregullimit të kushteve të sigurisë dhe teknologjisë që do të përdoret në përputhje me kushtet e përcaktuara në Programet 2 (**Kërkesat e Autoritetit)** dhe 3 (Zgjidhja e Konçesionerit).

(ii) (Përcaktimi i një rrjeti Zyrash për Aplikime të siguruara me personel të kualifikuar dhe regjistrim të përshtatshëm dhe pajisjet për aplikime për Dokumenta të identitetit në përputhje me kushtet e përcaktuara në Programet 2 (**Kërkesat e Autoritetit)** dhe 3 (Zgjidhja e Konçesionerit);

(iii) Përcaktimi nga Koncesioneri i ndërtesës së Mbështetjes (Back-Up) të ndodhur në Bazën Ushtarake të Kuçovës, Shqipëri me qëllim ruajtjen e sigurtë të të gjitha të dhënave të mbështetjes (back-up) (Të Dhëna Biometrike dhe të dhëna të tjera që lidhen me Koncesionin) në përputhje me kushtet e përcaktuara Programet 2 (**Kërkesat e Autoritetit)** dhe 3 (Zgjidhja e Koncesionerit);

(iv) hartimi, zbatimi dhe operimi nga Koncesioneri i një sistemi kompjuterik të plotë dhe të integruar, i cili do të mbështesë të gjitha llojet e proceseve të cituara më lart në nivel lokal (në Zyrat e Aplikimeve) dhe në nivel qëndror (Zyra Qëndrore e Personalizimit).

3.2 Periudha e Koncesionit

Koncesioni këtu i dhënë është për një periudhë minimale prej 5 (pesë) vjetësh nga Data Efektive dhe përfundon në ditën e përvjetorit të 5-të të datës Efektive ("Periudha Efektive"). Megjithatë, në rastin e Përfundimit, Periudha e Koncesionit do të nënkuptojë dhe do të kufizohet tek periudha që fillon nga Data Efektive dhe mbaron në Datën e Përfundimit.

3.3 Mekanizmat e rinovimit

3.3.1 Pas një periudhe prej 2 (dy) vitesh duke filluar nga Data Efektive, Palët do të takohen me qëllim që të diskutojnë pa detyrime afatet dhe kushtet për një zgjatje të afateve dhe kushteve për një shtyrje të Periudhës së Koncesionit.

3.3.2 Për një shtyrje të Periudhës së Koncesionit mund të bihet dakord ndërmjet palëve në rastin e një Ngjarjeje të Forcës Madhore për një periudhë kohe që e kalon 1 (një) muaj.

3.3.3 Palët bien dakord që Periudha e Koncesionit do të zgjatet për një periudhë që pasqyron periudhën kohore në të cilën Autoriteti shkakton një vonesë në përftimin e një license, leje apo autorizimi të kërkuar për përmbushjen nga ana e Koncesionerit që rrjedh nga dhe/ ose është e lidhur me këtë Marrëveshje.

3.3.4 Palët bien dakord që Periudha e Koncesionit do të zgjatet për periudhën e kohës në të cilën vonesa e Autoritetit në kryerjen e dorëzimit të Mjedisit Qendror të Personalizimit dhe / ose Ndërtesës Mbështetëse (Back – up) sipas Nenit 39.5 dhe 39.6 i shkakton Koncesionerit vonesë në përmbushjen e detyrimeve të veta.

3.3.5 Një zgjatje e Periudhës së Koncesionit do të bihet dakord ndërmjet Palëve në rastet e ndodhjes së Forcës Madhore – Force Majeure, për një periudhë që tejkalon 1 (një) muaj.

3.4 Eskluziviteti

3.4.1 Të Drejtat e Koncesionit do të jenë eskluzive dhe Koncesioneri do të ketë të drejtën e vetme dhe eskluzive të ushtrojë Të Drejtat e Koncesionit të dhëna sipas kësaj Marrëveshje përveç rastit të Ndërhyrjes.

3.4.2 Autoriteti përveç rastit të Ndërhyrjes, nuk do të hyjë në, ose deklarojë të hyjë në çfarëdo Marrëveshjesh me palë të treta të cilat mund të japin ose deklarojnë të japin të drejtat e identifikuara në Dispozitën 3.1 (Dhënia e Koncesionit) një pale të tretë ose të marrë çdo masë duke përfshirë mbylljen e kontratës e cila mund të ndikojë negativisht të drejtat eskluzive të dhëna Koncesionerit sipas kësaj Marrëveshjeje.

3.5 Autorizime, Leje dhe Licenca

3.5.1 Autoriteti do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të siguruar që, çdo Ent Shtetëror nën autoritetin e drejtpërdrejtë të Autoritetit, që i nënshtrohet marrjes nga Enti Shtetëror i një njoftimi me shkrim nga Koncesioneri, do t'i lëshojë Koncesionerit autorizimet, licencat dhe lejet në lidhje me zbatimin e Koncesionit, me kusht që Koncesioneri i ka përmbushur kërkesat për aplikimin e licencave, autorizimeve dhe lejeve të tilla.

3.5.2 Deri në masën që Autoriteti ose çdo Ent Shtetëror (i cili është nën autoritetin e drejtpërdrejtë të Autoritetit) nuk ka të drejtë të lëshojë autorizime, Autoriteti do të bëjë përpjekjet e tij më të mira për të siguruar që autorizimet, lejet dhe licencat t'i lëshohen Koncesionerit në përputhje me këtë Marrëveshje dhe Ligjin e Zbatueshëm, pa vonesa të paarsyeshme pasuar nga një aplikim i nevojshëm i paraqitur nga Koncesioneri.

3.5.3 Autoriteti do të bëjë përpjekjet e duhura për të siguruar që të gjitha Entet Shtetërore që ushtrojnë autoritetin e tyre përkatës në lidhje me Koncesionin të jenë të informuara në mënyrën e duhur në lidhje me ekzistencën e kësaj Marrëveshje dhe që të gjitha Entet Shtetërore që ushtrojnë autoritetin e tyre përkatës në lidhje me Koncesionin do të bashkëpunojnë pa vonesa të paarsyeshme, me Koncesionerin në lidhje me zbatimin e Koncesionit.

3.6 Rikthimi i Mjediseve të Koncesionit dhe Lehtësirave

3.6.1 Me mbarimin e Periudhës së Koncesionit, Koncesioneri do të rikthejë posedimin e lirë dhe të paqtë të vendndodhjeve (mjediseve) të Koncesionit ndaj Autoritetit në pajtim me Nenin 3.7.

3.6.2 Proçesi i rikthimit do të fillohet të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara datës së mbarimit të Periudhës së Koncesionit nga një inspektim i përbashkët i Autoritetit dhe Koncesionerit.

3.7 Proçedura e rikthimit

3.7.1 Palët bien dakord që në vijim të mbarimit të datës së Periudhës së Koncesionit, çdo e drejtë apo titull i dhënë ndaj Koncesionerit në lidhje me vendndodhjet (mjediset) e Koncesionit, pasuritë dhe mjediset e tjera lehtësuese do të përfundojnë dhe Koncesioneri:

(i) do t'i kalojë Autoritetit çdo të drejtë ose titull në lidhje me vendndodhjet (mjediset) e Koncesionit, Pasuritë e Reja apo ekzistuese duke përfshirë të gjithë përbërësit që formojnë Sistemin duke futur këtu kalimin,

përmirësimin dhe / ose transferimin e të gjitha programeve kompjuterike të përdorura në operimin dhe zhvillimin e Sistemit.

(ii) do t'i dorëzojë Autoritetit të gjitha dokumentet dhe të dhënat në posedim të tij në lidhje me të gjitha temat që kanë të bëjnë me operimin e Koncesionit nga Koncesioneri pa pagesa, detyrime apo tarifa të mëtejshme.

3.7.2 Autoriteti bie dakord dhe merr përsipër që brenda 30 ditëve nga transferimi i të drejtave, titujve në lidhje me vendndodhjet (mjediset) e Koncesionit, Pasurive të Reja apo Ekzistuese, përfshirë transferimin e të gjithë përbërësve që formojnë Sistemin duke futur këtu kalimin, përmirësimin dhe / ose transferimin e të gjitha programeve kompjuterike të përdorura në operimin dhe zhvillimin e Sistemit, nga Koncesioneri dhe dorëzimin e dokumenteve përkatëse siç është parashikuar në paragrafin (ii) më lart, ai do të lëshojë dhe dërgojë Çertifikatën e Rikthimit në pajtim me Programin 14 (Çertifikata e Pranimit të Dorëzimit dhe Rikthimit) të kësaj Marrëveshjeje për Koncesionerin.

3.7.3 Koncesioneri do të sigurojë që të gjitha pronat, pasuritë, të drejtat dhe artikujt e tjerë të referuara sipas këtij Neni të cilat janë të bashkëngjitura apo të transferuara tek Autoriteti, do të jenë në kushte të mira pune dhe në një gjendje të mirë riparimi të tilla që Sistemi të jetë në gjendje për të punuar nën kushte normale për një periudhë të mëtejshme trevjeçare pa pasur nevojë për të zëvendësuar ndonjë përbërës përveç atyre të Konsumueshme, pa marrë përsipër çfarëdo detyrimi garancie përtej afatit prej një viti pas mbarimit të Periudhës së Koncesionit.

3.7.4 Koncesioneri, mbi miratimin me shkrim të furnizuesve do të kalojë tek Autoriteti në kushte dhe afate të ngjashme siç parashikohet për Koncesionerin të gjitha kontratat e mirëmbajtjes që i përkasin Sistemit.

3.7.5 Ndërsa të gjitha pasuritë e Koncesionerit, duke përfshirë të gjithë përbërësit që përbëjnë sistemin do të transferohen tek Autoriteti në ditën e përfundimit të Periudhës së Koncesionit, vetë Koncesioneri nuk do të transferohet tek Autoriteti.

3.8 Palët do të bien dakord mbi proçeset e hollësishme dhe autorizimet për të lëshuar pasaporta diplomatike dhe shërbimi ndaj shtetasve që kualifikohen për të tilla pasaporta.

4. Data Efektive e Marrëveshjes

4.1 Data Efektive:

4.1.1 Data Efektive e kësaj Marrëveshje do të jetë data në të cilën do të jenë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:

(i) ekzekutimi i kësaj Marrëveshje nga të dyja Palët në Datën e Ekzekutimit;

(ii) hyrja në fuqi e Vendimit të Këshillit të Ministrave që miraton këtë Marrëveshje.

4.1.2 Autoriteti merr përsipër të paraqesë para Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, menjëherë pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, për miratim Marrëveshjen dhe të propozojë ndryshimet e nevojshme në Ligjin e Zbatueshëm (Ligji për Konçesionin e Kartave të Identitetit) për të bërë efektive disa nga dispozitat e kësaj Marrëveshje.

4.2 Mosarritja e respektimit të Datës Efektive.

4.2.1 Në rast se Data Efektive nuk hyn në veprim brenda një periudhe prej 60 ditësh që nga Data e Ekzekutimit të kësaj Marrëveshje, secila nga Palët do të ketë të drejtën që ta përfundojë këtë Marrëveshje duke dhënë një Njoftim Përfundimi ndaj Palës tjetër. Në vijim të marrjes së një Njoftimi Përfundimi të tillë, Palët në këtë Marrëveshje nuk do të kenë të drejta apo detyrime të mëtejshme sipas kësaj Marrëveshje (përveç të drejtave dhe detyrimeve të tilla që sipas termave të tyre të shprehura janë mbi përfundimin e kësaj Marrëveshje sipas Nenit 43 (Konfidencialiteti) dhe Nenit 66 (Ligji rregullues dhe Arbitrazhi).

5. Plani i Projektit

5.1 Konçesioneri do të sigurojë Shërbimet në përputhje me Planin e Projektit. Koha do të jetë thelbësore në lidhje me këtë Marrëveshje dhe Planin e Projektit.

5.2 Konçesioneri do t'i sigurojë Autoritetit për miratim, dizenjimin e Dokumentave të Identitetit brenda 30 ditëve nga Data Efektive e cila do të përfshijë të gjithë elementët e sigurisë. Autoriteti do të paraqesë komentet e tij brenda 10 ditëve nga marrja dhe Konçesioneri do të ndryshojë dizenjon dhe riparaqesë Autoritetit për miratim brenda 12 ditëve të marrjes komentet e Autoritetit. Kur dizenjimi të jetë miratuar nga Autoriteti mund të përdoret për qëllime testimi dhe prodhimi.

6. Prova

6.1 Kur Konçesioneri të konsiderojë se Sistemi është gati për tu provuar, ai do të paraqesë sistemin për provë dhe Palët do të ndjekin dispozitat e zbatueshme të Proçedurave të Provës.

6.2 Konçesioneri do të përballojë të gjitha kostot në lidhje me Proçedurat e Provës.

6.3 Nëse Konçesioneri i kalon me sukses Provat e kërkuara, Autoriteti do të lëshojë një Çertifikatë Pranimi. Pavarësisht nga lëshimi i çfarëdo Çertifikate Pranimi, Konçesioneri do të mbetet i vetmi përgjegjës për të siguruar që Zgjidhja, siç janë projektuar dhe zhvilluar, të jetë e përshtatshme për kryerjen e Shërbimeve, për të siguruar që Shërbimet janë vënë në jetë në përputhje me këtë Marrëveshje dhe që Nivelet e Shërbimit janë arritur. Asnjë e drejtë për tërheqje apo çlirim nga porosia nuk do të vijë si rrjedhim i lëshimit të një Çertifikatë Pranimi.

6.4 Nëse Konçesionerit nuk i jepet Çertifikata e Pranimit në apo përpara Datës së Pikësynimit 5 në lidhje me kartat e identitetit dhe Pikësynimit 6 në lidhje me Pasaportat, pas një periudhe tolerimi prej një jave për secilin nga këto Pikësynime, do të zbatohen si

të jetë e përshtatshme dispozitat e Neneve 7 (Vonesat në zbatim – Dispozita të Përgjithshme), 8 (Vonesat për Shkak të Pazotësisë së Koncesionerit), dhe 9 (Vonesa në Pikësynime për shkak të Autoritetit).

7. Vonesat në zbatim – Dispozita të Përgjithshme

7.1 Nëse, në çdo kohë, Koncesioneri ndërgjegjësohet se ai nuk do të (apo se ka pak të ngjarë që të) Arrijë cilindo nga Pikësynimet në Datën e Pikësynimit, ai do të njoftojë menjëherë Autoritetin mbi faktin e Vonesës e dot ë përmbledhë arsyet për këtë.

7.2 Koncesioneri, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se sa 10 ditë pune pas njoftimit fillestar sipas Nenit 7.1, do t'i japë Autoritetit hollësi të plota me shkrim për:

7.2.1 Arsyet e Vonesës;

7.2.2 Pasojat e Vonesës; dhe

7.2.3 Nëse Koncesioneri pretendon se Vonesa vjen për shkak të Autoritetit, arsyen pse e paraqet atë pretendim.

7.3 Në qoftë se Vonesa i detyrohet një Shkaku të Autoritetit, Koncesioneri do të vërë në përdorim të gjitha burimet shtesë dhe do të marrë të gjitha hapat e arsyeshme për të shmangur apo ulur pasojat e Vonesës, me kusht që çfarëdo kostosh të tilla shtesë të pësuara nga Koncesioneri për shkak të Pazotësisë së Autoritetit të jenë miratuar paraprakisht me shkrim se sa të bëheshin të nevojshme nga Autoriteti, përveçse në rastin e një emergjence kur Koncesioneri ka nevojë të përballet me shpenzime kur nuk ka kohë të mjaftueshme për të marrë miratimin Koncesioneri do të rimbursohet për kosto të tilla të arsyeshme e të nevojshme shtesë.

7.4 Çfarëdo konflikti në lidhje me apo si rrjedhojë e Vonesave do të zgjidhet përmes Proçedurës për Zgjidhjen e Konflikteve. Gjatë kohës së zgjidhjes së Konfliktit të dy Palët do të vazhdojnë të punojnë për të zgjidhur shkaqet apo për të ulur pasojat e Vonesës.

7.5 Koncesioneri do të paraqesë një projekt të Planit të Korrigjimit kur:

7.5.1 ai ndërgjegjësohet se nuk do të Arrijë Pikësynimin në Datën përkatëse të Pikësynimit; ose

7.5.2 ai ka dështuar në përpjekjen që të Arrijë një Pikësynim në Datën e këtij Pikësynimi, nëse ky dështim vjen si rrjedhojë e:

(i) mosarritjes për të paraqitur cilindo apo të gjithë Produktet në lidhje me atë Pikësynim;

(ii) dështimit të Pikësynimit për të kompletuar apo Arritur me sukses çfarëdo Prove; ose

(iii) atje ku nuk janë parashikuar Prova në lidhje me Pikësynimin përkatës, çfarëdo mospërputhje në lidhje me atë Pikësynim.

7.6 Projekt Plani i Korrigjimit do të identifikojë çështjet që rrjedhin nga Vonesa dhe hapat që Koncesioneri propozon që të ndërmerren për të Arritur Pikësynimin në përputhje me këtë Marrëveshje.

7.7 Projekt Plani i Korrigjimit do t'i paraqitet Autoritetit për miratim sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se 10 ditë pune (apo një periudhë kohore tjetër të tillë që Autoriteti mund të lejojë dhe të njoftojë Koncesionerin me shkrim) pas njoftimit fillestar sipas Nenit 6.1 ose do të lëshohet-një Raport Mos – përputhje.

7.8 Autoriteti nuk do të refuzojë miratimin e tij për një Projekt Plan Korrigjimi në mënyrë të paarsyeshme. Nëse Autoriteti nuk miraton Projekt Planin e Korrigjimit, ai do të informojë Koncesionerin mbi arsyet e tij dhe Koncesioneri do të marrë parasysh këto arsye në përgatitjen e Projekt Plani të mëtejshëm të Korrigjimit, i cili do t'i paraqitet Autoritetit brenda 5 ditësh pune nga refuzimi i projektit të parë.

7.9 Koncesioneri do të veprojë në përputhje me Planin e tij të Korrigjimit në vijim të miratimit të tij nga Autoriteti.

7.10 Palët bien dakord që marrja nga Koncesioneri dhe / ose Nën – kontraktuesit e tij të të gjitha licencave, autorizimeve dhe lejeve të kërkuara për ndërtimin dhe punimet rinovuese për sa i përket Mjedisit Qendror të Personalizimit siç janë përcaktuar në Programin 3 (Zgjidhja e Koncesionerit) do të jetë e nja natyre thelbësore për vënien në jetë të kësaj Marrëveshje. Në rast vonese për më shumë se 45 ditë në marrjen e licencave dhe autorizimeve të tilla pas datës së paraqitjes nga Autoriteti të aplikimit të plotësuar saktësisht dhe / ose më shumë se një javë në përftimin nga Autoriteti të dokumentave të nevojshme siç përcaktohet në Programin 8 për paraqitjen e licencave dhe autorizimeve të tilla, Koncesioneri nuk do të quhet se është në vonesë sipas kësaj Marrëveshje për ato vonesa që rrjedhin nga licenca e vonuar dhe Koncesioneri do të çlirohet nga çfarëdo dënimi apo pasoje të Vonesës sipas kësaj Marrëveshje që rrjedh nga licenca e vonuar dhe Periudha e Koncesionit do të zgjatet në përputhje me periudhën e vonesës, nëse Palët nuk arrijnë një zgjidhje tjetër.

8. Vonesat për Shkak të Pazotësisë së Koncesionerit

8.1 Nëse Sistemi nuk përmbush Kriteret e Pranimit të përcaktuara në Programin 6 dhe / ose secili nga 6 Pikësynimet nuk Arrihet si pasojë e Pazotësisë së Koncesionerit, Autoriteti do të lëshojë një Raport të Mos – përputhjes ndaj Koncesionerit duke kategorizuar Çështjet e Provës siç përshkruhen në Procedurat e Provës apo duke përcaktuar me hollësi mospërputhjet e Sistemit atje ku janë kryer prova, duke përfshirë këtu çfarëdo arsye tjetër për Mosarritjen e Pikësynimit përkatës dhe pasojat vijuese mbi Pikësynimet e tjera. Autoriteti do të ketë pastaj për të vepruar, mundësitë e parashikuara në Nenin 8.2.

8.2 Autoriteti mundet që, në vlerësimin e tij (pa hequr dorë nga asnjë e drejtë në lidhje me mundësitë e tjera) të zgjedhë që:

8.2.1 nëse problemi i provës së pranimit nuk është një Problem i Provës materiale, të lëshojë një Çertifikatë Pranimi duke e kushtëzuar atë me rregullimin e Problemit të Provës, ose të mospërputhjeve të Sistemit atje ku nuk janë kryer prova, në përputhje me Planin e Korrigjimit të rënë dakord; dhe / ose

8.2.2 nëse problemi i provës së pranimit është një Problem i Provës Materiale, të refuzojë të lëshojë një Çertifikatë Pranimi të kushtëzuar siç përcaktohet me hollësi në Nenin 8.2.1 dhe t'i referohet çështjes së Proçesit të Përshkallëzimit dhe nëse çështja nuk mund të zgjidhet, të ushtrojë çdo të drejtë që ai mund të ketë sipas Nenit 50 (Përfundimi); dhe / ose

8.2.3 të kërkojë pagimin e Pagesave të Vonesës, të cilat do të jenë të pagueshme nga ana e Koncesionerit sipas kërkesës, atje ku Programi 16 (Çështje Financiare) identifikon se Pagesat e Vonesës janë të pagueshme në lidhje me Pikësynimin përkatës. Pagesat e Vonesës do të mblidhen mbi një bazë javore për çdo javë të plotë, që nga data e Pikësynimit përkatës dhe do të vazhdojnë të mblidhen deri në datën kur Pikësynimi të Arrihet në përputhje me Planin e Korrigjimit. Për qëllimet e vlerësimit nëse Koncesioneri ka dështuar apo jo në Arritjen e një Pikësynimi, afati për një vlerësim të tillë do të caktohet në orën 12.00 GMT të ditës së Pikësynimit.

8.3 Atje ku Programi 16 (**Çështje Financiare**) nuk identifikon pagimin e Pagesave të Vonesës në lidhje me një Pikësynim, Autoriteti rezervon të drejtat e tij. Pagesat e Vonesës janë një rregullim i parë për Mosarritjen nga ana e Koncesionerit të Datës përkatëse të Pikësynimit.

8.4 Atje ku Autoriteti lëshon një Çertifikatë Arritje të kushtëzuar siç përcaktohet me hollësi në Nenin 8.2.1, ai mund të zgjedhë (por nuk është i detyruar) që të rishikojë datën e paarritur të Pikësynimit dhe çdo datë vijuese Pikësynimi.

8.5 Çdo Plan Korrigjimi do të bihet dakord përpara lëshimit të një Çertifikate Arritje të kushtëzuar përveçse kur Autoriteti është i gatshëm të bjerë dakord ndryshe. Në rastin e fundit, Koncesioneri do të paraqesë një Plan Korrigjimi për miratim nga Autoriteti brenda 10 ditëve pune që nga marrja e Raportit të Mospërputhjes.

8.6 Të gjitha Pagesat e Vonesës të pagueshme nga Koncesioneri për Autoritetin do të paguhen si dënim për vonesën.

8.7 Pagimi i Pagesave të Vonesës nuk do ta çlirojë Koncesionerin nga detyrimet e tij për të Përmbushur Kriteret e Pranimit të përcaktuara në Programin 6 dhe / ose një Pikësynim në përputhje me Planin e Projektit apo çdo Plan Korrigjimi të rënë dakord apo nga çdo përgjegjësi apo detyrim tjetër sipas kësaj Marrëveshje. Dispozitat e këtij Neni nuk e ndalojnë Autoritetin nga ushtrimi i cilësdo nga të drejtat e tjera të tij sipas kësaj Marrëveshje, apo nga kërkimi i dëmshpërblimeve të përgjithshme sipas ligjit në rastin kur Koncesioneri vazhdon në mosarritjen e tij për të Përmbushur Kriteret e zbatueshme të Pranimit të përcaktuara në Programin 6 dhe / ose një Pikësynim.

9. Vonesat në Pikësynime për Shkak të Autoritetit

9.1 Pa paragjykim ndaj Nenit 7.3 dhe duke iu nënshtruar Nenit 7.4, nëse Koncesioneri do të kishte qenë i aftë që të arrinte Pikësynimin në Datën e tij të Pikësynimit por nuk arritur ta bëjë këtë si rrjedhim i një Shkaku të Autoritetit atëherë, pasi Koncesioneri të ketë dhënë njoftim paraprak me shkrim për Autoritetin mbi Shkakun e Autoritetit dhe çdo pretendim për lehtësim brenda 7 ditësh nga dalja e Shkakut të Autoritetit ose nga data në të cilën Koncesioneri bëhet i ndërgjegjshëm apo duhet arsyeshmërisht të bëhej i ndërgjegjshëm (cilado të jetë më e vonshme), Koncesioneri do të përfitojë nga të drejtat dhe lehtësimi i përcaktuar në këtë Nen.

9.2 Nëse Autoriteti, duke vepruar në mënyrë të arsyeshme, është i bindur se një mosarritje për të Përmbushur një Pikësynim ka ardhur si rrjedhim i një Shkaku të Autoritetit, atëherë Koncesioneri:

9.2.1 sipas Nenit 9.3, do t'i lejohet një shtrirje e afatit e barabartë me Vonesën e shkaktuar nga Shkaku i Autoritetit;

9.2.2 nuk do të quhej se është në shkelje të kësaj Marrëveshje si rrjedhim i mosarritjes për të Përmbushur Pikësynimin përkatës në Datën e tij të Pikësynimit; dhe

9.2.3 nuk do të ketë përgjegjësi për Pagesat e Vonesës në lidhje me Pikësynimin përkatës në masën që Vonesa vjen drejtpërdrejt nga Shkaku i Autoritetit.

9.2.4 do të ketë të drejtën të ngrejë pretendime për shpenzimet e kryera nga Koncesioneri për shkak të Pazotësisë së Autoritetit me kusht që çfarëdo kostosh të tilla shtesë të jenë miratuar me shkrim nga Autoriteti përpara se sa të kryhen, përveçse në rastin e një emergjence kur Koncesioneri ka nevojë të përballet me shpenzime kur nuk ka kohë të mjaftueshme për të marrë miratimin Koncesioneri do të rimbursohet për kosto të tilla të arsyeshme e të nevojshme shtesë.

9.3 Autoriteti:

9.3.1 do ta marrë në konsideratë kohëzgjatjen e Vonesës, natyrën e Pazotësisë së Autoritetit dhe pasojën e Vonesës si edhe Pazotësinë e Autoritetit mbi aftësinë e Koncesionerit për të vepruar në përputhje me Planin e Zbatimit;

9.3.2 do të këshillohet me Përfaqësuesin e Koncesionerit në përcaktimin e pasojës së Vonesës dhe në atë se si të pakësohen pasoja të tilla atje ku kjo është e praktikueshme arsyeshmërisht;

9.3.3 caktojë një Datë të Rishikuar të Pikësynimit; dhe

9.3.4 nëse është e përshtatshme, të bëjë çdo rishikim vijues ndaj Pikësynimeve vijuese në Planin e Zbatimit.

9.4 Çdo periudhë apo periudha të zgjatura për plotësimin e Pikësynimit do t'i nënshtrohen rishikimit të rregullt, me kusht që asnjë rishikim i tillë të mos passjellë një rritje të cilësdo zgjatje kohe tashmë të njohur nga Autoriteti, përveçse kur rrethanat e Vonesës kanë ndryshuar në një mënyrë të tillë që kjo zgjatje të bëhet e arsyeshme dhe Autoritetit, duke vepruar arsyeshmërisht, të ketë rënë dakord për një zgjatje të kohës së dhënë më parë

9.5 Çfarëdo Ndryshimi që kërkohet në Planin e Projektit në përputhje me Nenin 9.3 do të vihet në jetë në përputhje me Proçedurën e Kontrollit të Ndryshimit. Nëse analiza e Koncesionerit mbi pasojën e Vonesës në përputhje me Nenin 7.2 lejon një numër mundësish, atëherë Autoriteti do të ketë të drejtën që zgjedhë se cilin mundësi të zbatojë.

9.6 Autoriteti nuk do të vonohet paarsyeshmërisht kur të marrë në shqyrtim dhe kur të përcaktojë pasojën e një Vonese sipas këtij Neni 9 ose në rënien dakord për një Ndryshim sipas Proçedurës së Kontrollit të Ndryshimit.

9.7 Koncesioneri do të ndërmarrë dhe vazhdojë (dhe do të sigurojë që secili Nën – kontraktor të ndërmarrë e të vazhdojë) të gjitha hapat e arsyeshme për të zhdukur apo ulur çfarëdo humbjesh dhe / ose shpenzimesh që ai ka si rrjedhojë e një Shkaku të Autoritetit.

9.8 Dështimi nga ana e Koncesionerit për të Përmbushur një Pikësynim si rrjedhim i një Shkaku të Autoritetit nuk do të vlerësohet si bazë për përfundim nga ana e Koncesionerit ose sikur i jep atij të drejtë ta trajtojë veten si të shkarkuar, dhe të drejtat dhe çlirimet e parashikuara në këtë Nen 9 do të jenë rregullimi i vetëm dhe ekskluziv / përjashtimor i Koncesionerit në lidhje me një mosarritje apo dështim të tillë.

10. Shërbimet

10.1 Koncesioneri do të sigurojë Shërbimet dhe do të sigurojë që Shërbimet:

10.1.1 të përputhen në të gjitha aspektet me Kërkesat e Autoritetit siç përcaktohet tek Programi 2 (Kërkesat e Autoritetit), ashtu siç vetë kjo mund të ndryshojë gjatë Afatit / Termit dhe siç ato mund të shtohen, zgjerohen, ndryshohen apo zëvendësohen në përputhje me proçedurën e Kontrollit të Ndryshimit dhe siç shtohet në Programin 4 (Lista e ndryshimeve të rëna dakord ndaj Programit 2 (Kërkesat e Autoritetit) dhe Programi 3 (Përfundimet Zgjidhja e Koncesionerit));

10.1.2 këtë Marrëveshje;

10.1.3 të jepen në përputhje me Zgjidhjen e Koncesionerit të parashikuar në Programin 3 (Zgjidhja e Koncesionerit) siç shtuar në Programin 4 (Lista e ndryshimeve të rëna dakord ndaj Programit 2 dhe 3 (Dokumentat e tenderit);

10.1.4 të përputhen në çdo kohë me Programet e parashikuara në këtë Marrëveshje përfshirë këtu Planin e Zbatimit, Programin 2 (Përgjegjësitë e Autoritetit) dhe Programin 3 (Zgjidhja e Koncesionerit)

10.2 Pa paragjykim ndaj Nenit 10.1, Koncesioneri do të ofrojë këto Shërbime Operacionale:

10.2.1 Nga marrja e një Çertifikate Pranimi; dhe

10.2.2 Në përputhje me Nenin 11.

10.3 Koncesioneri do të kryejë detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshje duke përfshirë ato në lidhje me Shërbimet në përputhje me:

10.3.1 Praktikat e Industrisë së Përparuar;

10.3.2 Proçedurat dhe praktikat e vendosura nga ana e vetë Koncesionerit;

10.3.3 Politikën e Sigurisë;

10.3.4 Planet e Cilësisë;

10.3.5 Të gjitha udhëzimet e arsyeshme të dhëna ndaj Koncesionerit nga Përfaqësuesi i Projektit për Autoritetin gjatë Termit / Afatit në masën që këto udhëzime lidhen apo përkojnë me Shërbimet me kusht që këto udhëzime të mos jenë në mospërputhje me këtë Marrëveshje; dhe

10.3.6 Nivelin e aftësive profesionale, kujdesit, planifikimit, mbikqyrjes, kontrollit dhe gjykimit të cilat mund të priten nga një shoqëri profesioniste më përvojë në dhënien shërbimeve të tipit dhe kompleksitetit të kërkuar nga Autoriteti sipas kësaj Marrëveshje.

10.4 Në shtrirjen në të cilën ai mund të bëhet kohë pas kohe i ndërgjegjshëm, Koncesioneri do të sjellë çdo konflikt ndërmjet cilësdo nga kërkesat e Nenit 10.1 dhe kërkesat e Nenit 10.2.2 në vëmendjen e Autoritetit dhe do të veprojë në përputhje me vendimin e Palëve për zgjidhjen e atij konflikti. Atje ku një vendim i Autoritetit është në kundërshtim me rendin e preçedencës të përmendur në Nenin 1.5 të kësaj Marrëveshje, ky ndryshim do t'i nënshtrohet Proçedurës së Kontrollit të Ndryshimi (përveç faktit që pranimi i Ndryshimit nuk do t'i nënshtrohet ndonjë miratimi nga Koncesioneri).

10.5 Koncesioneri do të sigurojë që Shërbimet dhe Sistemi i Koncesionerit të integrohen me Autoritetin e Sistemit në masën që është e nevojshme për të siguruar Shërbimet.

10.6 Duke iu nënshtruar Nenit 9.1, në rastin e mosarritjes së Koncesionerit për të siguruar Shërbimin apo për të vepruar në përputhje me detyrimet e tij në përputhje me këtë Marrëveshje, Autoriteti mundet që, pa paragjykuar të drejtat e tjera të tij, t'i kërkojë Koncesionerit që të rikryejë Shërbimet apo të veprojë në përputhje me detyrimet e tij.

11. Nivelet e Shërbimit

11.1 Koncesioneri do të sigurojë Shërbimet Operacionale që të arrijnë apo tejkalojnë Nivelet e Shërbimit nga data e Pikësynimit 5 në lidhje me Kartat e Identitetit dhe Pikësynimit 6 në lidhje me Pasaportat. Dispozitat e mbetura të këtij Neni 11 i nënshtrohen dispozitave të Nenit 12 (Pasoja e Shkakut të Autoritetit në Fazën Operacionale).

11.2 Nëse ka një Dështim të Shërbimit apo nëse Koncesioneri beson se do të ketë një Dështim të Shërbimit, Koncesioneri:

11.2.1 do të njoftojë Autoritetin menjëherë për Dështimin e Shërbimit apo Dështimin e mundshëm të Shërbimit;

11.2.2 do t'i sigurojë Autoritetit një Plan Korrigjimi të veprimit që ai do të ndërmarrë për të ndrequr Dështimin e Shërbimit që të mos ndodhë apo ndodhë përsëri, brenda 10 ditëve të punës nga data që Koncesioneri njofton Autoritetin sipas Nenit 11.2;

11.2.3 do të vërë në përdorim të gjitha burimet shtesë dhe do të ndërmarrë të gjitha veprimet rregulluese që janë të nevojshme për të ndrequr apo për të parandaluar Dështimin e Shërbimit që të ndodhë apo që të ndodhë përsëri; dhe

11.2.4 do të kryejë nja Plan Korrigjimi të rënë dakord sipas Nenit 11.2.2, në përputhje me termat e tij.

11.3 Duke iu nënshtruar kufirit të Kreditit të Shërbimit sipas Nenit 44.2.2, atje ku është e zbatueshme Koncesioneri do t'i paguajë Autoritetit Kreditet e Shërbimit në përputhje me Programin 4 (Nivelet e Shërbimit) brenda 20 ditëve të çdo muaji kalendarik.

12. Pasoja e Shkakut të Autoritetit në Fazën Operacionale

12.1 Nëse Koncesioneri do ti ofronte Shërbimet Operacionale në pajtim me Nivelet e Shërbimit dhe/ose këtë Marrëveshje, por ka dështuar të bëjë kështu si rezultat i Shkakut të Autoritetit, Koncesioneri do të ketë të drejtat dhe asistencën të parashikuara në Pikën 12.1. Koncesioneri:

12.1.1 (në matjen e kryerjes së çdo Shërbimi të ndikuar) do të trajtohet si në rastin që Shërbimi i përshtatshëm ka arritur Nivelin e Shërbimit të përshtatshëm; dhe

12.1.2 nuk do të trajtohet si të jetë në thyerje të kësaj Marrëveshjeje për përmbajtjen që mosekzekutimi ose prishja është për shkak të çdo Shkaku të Autoritetit; dhe

12.1.3 do të ketë të drejta ndaj Tarifave për shërbimet e përshtatshme të shkaktuara nga Shkaku i Autoritetit, sikur këto të mos kishin ndodhur.

12.1.4 do të ketë të drejtë të ngrejë pretendime për shpenzime të kryera nga Koncesioneri për shkak të Pazotësisë / Shkakut të Autoritetit me kusht që çfarëdo shpenzim i tillë shtesë të jetë miratuar paraprakisht me shkrim se po shkaktohet nga Autoriteti, përveçse në rastin e një emergjence kur Koncesioneri ka nevojë të përballet me shpenzime kur nuk ka kohë të mjaftueshme për të marrë miratimin Koncesioneri do të rimbursohet për kosto të tilla të arsyeshme e të nevojshme shtesë.

12.2 Nëse Koncesioneri pretendon se zbatohet Neni 12.1 , dhe me qëllim që të pretendojë të drejtat dhe asistencat e parashikuara në Paragrafin 12.1, do të pajisë Autoritetin me detajet e Shkakut të Autoritetit si pjesë e informacionit të menaxhimit që është i detyruar që të sigurojë në përputhje me Nenin 49.3.12.

12.3 Çdo konflikt për, ose që lind nëse një Shkak i Autoritetit aplikohet për dështimin e Koncesionerit për sigurimin e Shërbimeve në pajtim me Nivelet e Shërbimit dhe /ose këtë Marrëveshje do të zgjidhet përmes Procedurës së Zgjidhjeve të Konflikteve. Në pritje të zgjidhjeve të konflikteve të dyja palët do të vazhdojnë të zgjidhin çështjet dhe të zbusin efektet e këtij dështimi.

13. Standartet

Koncesioneri do të pajtohet me Standartet e përmendura apo të referuara në Programet 2 dhe 3, në fuqi në datën e ekzekutimit të kësaj Marrëveshje në përmbushjen e detyrimeve të tij në këtë Marrëveshje.

14. Siguria e Cilësisë dhe Vëzhgimi

14.1 Koncesioneri do të zhvillojë përpara Ditës së Fillimit, Plane të Cilësisë që:

14.1.1 Të sigurojnë që të gjithë aspektet e Shërbimeve janë subjekt i sistemeve të menaxhimit të cilësisë; dhe

14.1.2 Janë në përputhje me ISO 27000 ose çdo standard ekuivalent, i cili është i njohur gjerësisht që të ketë zëvendësuar atë standard.

14.1.3 për më tepër, Koncesioneri do të çertifikohet ISO270004 jo më vonë se sa data e Përvjetorit të tretë në vijim të Datës Efektive të kësaj Marrëveshje.

14.2 Koncesioneri do të sigurojë që Shërbimet të zhvillohen në pajtim me Planet e Cilësisë.

14.3 Vëzhgimi i Dorëzimit të Shërbimit

14.3.1 Autoriteti mund të kontrollojë kryerjen e Shërbimeve nga Koncesioneri në përputhje me proçedurat e përshkruara në Programin 2 (Kërkesat e Autoritetit).

14.3.2 Autoriteti mund të dojë që të rrisë përmbajtjen për të cilën zhvillohet ky kontroll nëse cilësia e Shërbimeve është degraduar në çfarëdo mënyre. Autoriteti do t'i japë Koncesionerit një njoftim të arsyetuar të mëparshëm me shkrim të qëllimit të tij për të rritur nivelin e vëzhgimit.

14.3.3 Koncesioneri do të bashkëpunojë dhe do të sigurojë që të gjithë nënkontraktuesit e tij të bashkëpunojnë me Autoritetin në zhvillimin e kontrollit të referuar në Nenin 14.3 pa detyrime shtesë për Autoritetin.

14.3.4 Nëse Koncesioneri beson se kontrolli i Autoritetit për Shërbimet është i paarsyeshëm, Koncesioneri mund të përshkallëzojë çështjen me Autoritetin duke përdorur Proçesin e Përshkallëzimit të konflikteve siç parashikohet në Programin 15.

15. Përmirësimi i Shërbimeve

15.1 Koncesioneri do të ketë një detyrim të vazhdueshëm përgjatë gjithë kohës për të identifikuar përmirësime të reja ose potenciale të Shërbimeve në pajtim me këtë Nen 15 dhe Programin 2 (Kërkesat e Autoritetit). Si pjesë e këtij detyrimi Koncesioneri do të identifikojë dhe raportojë tek Bordi i Menaxhimit të Projektit të përcaktuar në Programin 5 çdo tre muaj në vitin e parë të kontratës dhe çdo 6 muaj për kohën e mbetur të afatit për:

15.1.1 Nevojën e teknologjive përkatëse te reja dhe të zhvilluara, të cilat mund të përmirësojnë Sistemin dhe/ose Shërbimet, dhe këto teknologji të zhvilluara potencialisht të mundshme për Koncesionerin dhe Autoritetin, të cilat Palët duan të adoptojnë; dhe/ose

15.1.2 Përmirësime të reja ose të mundshme të Shërbimeve duke përfshirë cilësinë, përgjegjshmërinë, proçedurat, si mekanizmat e performancës dhe shërbimet mbështetëse të klientit në lidhje me Shërbimet; dhe/ose

15.1.3 Ndryshimet në proceset e punës të Dokumentave të Identitetit dhe në mënyrat e punës që mund të bëjnë të mundur që Shërbimet të dorëzohen me përfitim më të madh për Autoritetin.

15.2 Koncesioneri do të sigurojë që informacioni që do ti jepet Autoritetit të jetë i mjaftueshëm për Autoritetin që të përcaktojë nëse ndonjë përmirësim duhet të zbatohet. Koncesioneri do të japë çdo informacion të mëtejshëm që Autoriteti kërkon.

15.3 Nëse Autoriteti dëshiron të përfshijë ndonjë përmirësim të identifikuar nga Koncesioneri, Autoriteti do ti dërgojë Koncesionerit një Kërkesë Ndryshimi dhe palët do:

15.3.1 Zhvillojnë një plan për zbatimin e përmirësimit brenda një afati 20 ditë pune të Kërkesës së Ndryshimit të Autoritetit, për aprovimin e Autoritetit;

15.3.2 Zbatojnë përmirësimin në përputhje me parashikimet e një plani të zbatimit, i miratuar nga Autoriteti; dhe

15.3.3 T'i nënshtrojnë përmirësimet për tu testuar, në pajtim me parashikimet e nenit 6 (Testimi).

16. Sistemi

16.1 Përveç rasteve që është rënë dakord me shkrim ndryshe nga Autoriteti , ose vendosur ndryshe në këtë Marrëveshje, Sistemi do të përdoret nga Koncesioneri vetëm për qëllimet e ofrimit të Shërbimeve për Autoritetin dhe nuk do të përdoret për qëllimet e veta të Koncesionerit ose për ofrimin e shërbimeve të tjera palëve të treta.

16.2 Duke pasur parasysh që Autoriteti do të ofrojë dhe sigurojë të njëjtin nivel sigurie dhe të praktikojë të njëjtën shkallë përkushtimi, kujdesi dhe kontrolli në lidhje me pronat e Koncesionerit të lokalizuara në Mjedise, njësoj si për kujdesin që ka për pronat e tij në Mjedise, të gjitha pronat e Koncesionerit të lokalizuara në Mjedise, duke përfshirë Asetet Ekzistuese, do të qëndrojnë në rrezikun dhe përgjegjësinë e Koncesionerit, sipas Nenit 38.

16.3 Duke i nënshtruar cilësdo dispozitë të shprehur të kësaj Marrëveshje për të kundërtën, humbja ose shkatërrimi për çdo arsye i Aseteve Ekzistuese që janë në çdo Mjedise, nuk do ta çlirojnë Koncesionerin nga detyrimi i tij për të pajisur Shërbimet, në pajtim me Nivelet e Shërbimit.

17. Çështje financiare

17.1 Tarifa e Koncesionit

Koncesioneri do të paguajë një tarifë ("Tarifa e Koncesionit") që arrin në 5 % të xhiros së përgjithshme (duke përjashtuar TVSH) mbi shitjet vjetore të Dokumentave të Identifikimit, në favor të Autoritetit për të drejtat dhe privilegjet e dhëna në këtë Marrëveshje, bazuar në deklarimet financiare të kontrolluara të Shoqërisë Koncesionere për çdo Vit Financiar.

17.2 Modalitetet e pagesës

Tarifa Vjetore e Koncesionit do të paguhet nga Koncesioneri brenda 4 (katër) muajve të parë të secilit vit bazuar në deklarimet financiare të kontrolluara për Vitin Financiar paraardhës.

17.3 Kostot dhe shpenzimet

17.3.1 Palët bien dakord që çfarëdo kostoje dhe shpenzimi në lidhje me vënien në jetë të Koncesionit do të jetë në përputhje me dispozitat e Programit 11 (Çështje financiare) të kësaj Marrëveshje.

17.3.2 Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje apo tjetërkund, secila Palë do të paguajë kostot e lidhura me vetë atë, drejtpërdrejt apo tërthorazi, për komunikimin, negocimin, përgatitjen dhe kryerjen e kësaj Marrëveshje.

17.4 Kostot dhe shpenzimet e rishikimit

17.4.1 Rishikimi i kostove dhe shpenzimeve të Koncesionit mbi pëlqimin e ndërsjelltë me shkrim të Palëve në përputhje me Proçedurën e Kontrollit të Ndryshimit. Një rishikim i tillë i kostove dhe shpenzimeve do të zbatohet gjithashtu në rastin e ndryshimeve të kërkuara nga Autoriteti në Sistem apo në Shërbimet e përshkruara në këtë Marrëveshje apo në përcaktimet e hollësishme të miratuara nga Autoriteti. Asnjë ndryshim i Sistemit apo Shërbimeve nuk do të vihet në jetë nga Koncesioneri pa një marrëveshje me shkrim ndërmjet Autoritetit dhe Koncesionerit mbi këto kosto shtesë.

17.4.2 Palët do të takohen dhe do të diskutojnë mbi rishikimin e kostove dhe shpenzimeve brenda 15 ditëve nga marrja e një njoftimi me shkrim nga pala tjetër. Koncesioneri nuk do të jetë i detyruar që të mbajë kosto shtesë në lidhje me ndryshimet e bëra për të vepruar në përputhje me standartet ndërkombëtare të detyrueshme të hyra në fuqi pas Datës së Ekzekutimit përveçse kur kosto të tilla janë rënë dakord në përputhje me Proçedurën e Kontrollit të Ndryshimit.

17.5 Çmimi për Njësi i Kartave të Identitetit dhe Pasaportave Elektronike

17.5.1 Çmimi për Njësi i Dokumenteve të Identitetit do të jetë çmimi i ofruar nga Koncesioneri dhe i pranuar nga Autoriteti, siç përcaktohet në këtë Marrëveshje si Programi 11 (Çështje Financiare). Çmimi për Njësi do të jetë çmim neto (duke përjashtuar TVSH). Për më tepër, Çmimi për Njësi nuk përfshin taksat apo detyrimet për vula, nëse ka të tilla, të zbatueshme sipas ligjit shqiptar.

17.5.2 Çmimi për Njësi përjashton kostot për aplikantët të transfertave financiare për në llogarinë bankare të Koncesionerit të kryera përmes institucioneve financiare.

17.5.3 Çmimi për Njësi do të paguhet ndaj Koncesionerit nga Aplikanti paraprakisht pas aplikimit për një dokument identiteti apo pasaportë elektronike.

17.6 Financimi i Koncesionit

17.6.1 Koncesioneri do të bëjë rregullime për një financim të përshtatshëm për qëllime të financimit (qoftë përmes financimit me kredi qoftë përmes pjesëmarrjes së përbashkët) të Koncesionit dhe përmbushjes së detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshje dhe nuk do të kërkohet asnjë autorizim apo miratim nga Autoriteti për një qëllim të tillë me kusht që Koncesioneri të mos nuk do të kërkojë, ngarkojë me barrë apo vendosë një peng mbi pasuritë / asetet ekzistuese, Pasuritë / Asetet e Reja apo mbi Sistemin pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit.

17.6.2 Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë Marrëveshje, Autoriteti Kontraktues nuk do të ketë asnjë detyrim që të japë kontribute të cilitdo lloj (financiare apo të tjera) në lidhje me Koncesionin.

18. Taksat

18.1 Koncesioneri do të zhdëmtojë Autoritetin në vazhdimësi për çdo detyrim, duke përfshirë çdo interes, gjobë, ose pagesa të kryera, të cilat janë vënë, kërkuar ose vlerësuar tek Autoriteti në çdo kohë, përsa i përket dështimit të Koncesionerit për të llogaritur ose të paguajë çdo Tatim mbi Vlerën e Shtuar lidhur me pagesat e bëra për Koncesionerin, sipas kësaj Marrëveshjeje. Çdo shumë që bie brenda fushës së Nenit 18.1 do të paguhet në fonde të qarta nga Koncesioneri për Autoritetin jo më pak se 5 Ditë Pune përpara datës në të cilën taksa ose detyrimi tjetër është i pagueshëm nga Autoriteti.

18.2 Duke iu nënshtruar Ligjit për Koncesionin e Dokumentave të Identifikimit, të gjitha Pajisjet, Artikujt e Konsumueshëm ose materialet e tjera të importuara në Republikën e Shqipërisë për përfitimin e Koncesionerit, duke përfshirë gjithashtu Nën – kontraktorët e Koncesionerit, me kusht që mallra të tilla të mishërohen në Sistem dhe / ose të përdoren në lidhje me Shërbimet, do të:

(i) përjashtohen nga të gjitha detyrimet doganore dhe të importit të tarifueshme sipas Ligjit Nr. 8449, datë 27 janar 1999 "Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë" ose çdo taksë apo tarifë tjetër importi e zbatueshme mbi mallrat e importuara bazuar në ligjin e zbatueshëm, dhe

(ii) përjashtohen nga zbatimi i tatimit mbi vlerën e shtuar mbi importet për tu vendosur sipas Ligjit nr. 7928, datë 27 prill 1995 "Mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar", siç ndryshuar.

19. Përfaqësuesit

19.1 Koncesioneri do të caktojë personat e emëruar si të tillë në Programin 13 (Personeli Kyç) si Përfaqësues i Koncesionerit. Përfaqësuesi i Koncesionerit do të ketë autoritetin të veprojë në emër të Koncesionerit në lidhje me çështjet e caktuara ose në lidhje me këtë Marrëveshje.

19.2 Autoriteti do të emërojë Përfaqësuesin e Autoritetit. Përfaqësuesi i Autoritetit do të ketë autoritetin për të vepruar në emër të Autoritetit në çështjet e përcaktuara në, apo në lidhje me, këtë Marrëveshje në përputhje me dispozitat mbi rregullimin siç mund të ripërcaktohen apo të bihen më tej dakord nga Palët.

19.3 Përfaqësuesi do të jetë mjaftueshëm me përvojë brenda organizatës së Koncesionerit dhe do t'i jepet autoritet i mjaftueshëm për të siguruar bashkëpunim të plotë në lidhje me veprimtarinë dhe menaxhimin e kësaj Marrëveshjeje.

19.4 Autoriteti mund t'i kërkojë Koncesionerit që të zëvendësojë Përfaqësuesin e Koncesionerit, në pajtim me Nenin 26 (Personeli).

20. Rregullimi

Palët bien dakord që të menaxhojnë këtë marrëveshje përmes dispozitave mbi rregullimin të përcaktuara në Programin 2 e 3 siç mund të përcaktohen apo të bihen dakord më tej nga Palët.

21. Nën-kontraktimi

21.1 Koncesioneri nuk do të nënkontraktojë asnjë nga detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje pa marrë miratimin me shkrim të Autoritetit, i cili, duke iu nënshtruar Nenit 21.1, nuk do të refuzohet ose vonohet në mënyrë të paarsyeshme. Koncesioneri nuk do të nënkontraktojë pa miratimin e mëparshëm më shkrim të Autoritetit më shumë se 40% të vlerës së kontratës. Për mënjanimin e dyshimit, furnizuesit e pajisjeve, dërgesave, programeve kompjuterike, njësive kompjuterike, nuk do të konsiderohen nën-kontraktorë sipas kësaj Marrëveshjeje.

21.2 Autoriteti mund të refuzojë ose të vonojë miratimin e tij kur konsideron, në baza të arsyeshme që:

21.2.1 Caktimi i një nën-kontraktori të propozuar mund të dëmtojë parashihet e Shërbimeve ose mundtë jetë në kundërshtim me interesat e Autoritetit; dhe/ose

21.2.2 Nën-kontraktuesi i propozuar është konsideruar të jetë jo i besueshëm dhe /ose nuk ka ofruar shërbime të arsyeshme për klientët e tjerë të tij; dhe /ose

21.2.3 Nën-kontraktuesi i propozuar punëson persona të papërshtatshëm.

21.3 Sipas Nenit 21.4, në bërjen e një kërkese sipas Nenit 21.1, Koncesioneri do të pajisë Autoritetin me informacionin e mëposhtëm për Nën-kontraktuesin e propozuar:

21.3.1 Emrin e tij dhe adresën;

21.3.2 Qëllimet për të cilat nën-kontraktuesi i propozuar do të punësohet, duke përfshirë qëllimin e çdo shërbimi që do të ofrohet nga nën-kontraktuesi i propozuar; dhe

21.3.3 çdo informacion i mëtejshëm i kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti.

21.4 Autoriteti ka miratuar angazhimin e nën-kontraktuesve të listuar në Programin 9 (Nënkontraktuesit e MIratuar), duke iu nënshtruar sigurimit nga Koncesioneri të informacionit të listuar në Nenin 21.3 brenda 20 ditëve pune nga Data Efektive (ose një periudhe tjetër që Palët mund të bien dakord).

22. Rishikimi i Shërbimit

Në çdo kohë, secila Palë ka të drejtë të kërkojë nga pala tjetër që të hyjë në diskutime në lidhje me rishikimin e Shërbimeve dhe gjithë ndryshimet e rënda dakord do të vihen në jetë përmes Procedurës për Kontrollin e Ndryshimit.

23. Kontrollet financiare

23.1 Autoriteti mund, jo më shumë se një herë në çdo Vit Kontrate lidhur me sa më poshtë, të kryejë kontrolle financiare për qëllimet e mëposhtme:

23.1.1 të verifikojë saktësinë e numrit të Kartave të Identitetit dhe Pasaportave të lëshuara;

23.1.2 të rishikojë integritetin, konfidencialitetin dhe sigurinë e të Dhënave të Autoritetit;

23.1.3 të rishikojë përputhjen e Koncesionerit me legjislacionin e zbatueshëm tek Shërbimet;

23.1.4 të rishikojë përputhjen e Koncesionerit me detyrimet e tij sipas Nenit 10.1 dhe 10.3 (Shërbimet) dhe 14 (Siguria Cilësore dhe Vëzhgimi);

23.1.5 të rishikojë çdo rregjistër arsyeshmërisht të kërkuar të krijuar gjatë skicimit dhe zhvillimit të Sistemit dhe rrethanat para-operacionale duke përfshirë informacionin lidhur me përbërësit dhe skicimin e sistemit, përcaktimet e hollësishme të testit, raportet e testimit të rezultateve dhe planet e zbatimit dhe raportet;

23.1.6 të rishikojë çdo libër llogarie të mbajtur nga Koncesioneri lidhur me sigurimin e Shërbimeve;

23.1.7 të inspektojë Sistemin (ose çdo pjesë të tij); dhe

23.1.8 të sigurojë që Koncesioneri është duke vepruar në përputhje me Standartet.

23.2 Autoriteti do të bëjë përpjekjet e tij të arsyeshme për të siguruar që kryerja e e secilit kontroll financiar nuk e ndërpret në mënyrë të pa-arsyeshme Koncesionerin ose të shkaktojë vonesa në sigurimin e Shërbimeve.

23.3 Kushtëzuar nga detyrimet e Autoritetit të konfidencialitetit, Koncesioneri do ti sigurojë menjëherë Autoritetit (dhe/ose agjentëve të tij ose përfaqësuesve) me të gjithë bashkëpunimin e arsyeshëm dhe ndihmën lidhur me çdo kontroll financiar, duke përfshirë:

23.3.1 të gjithë informacionin e kërkuar nga Autoriteti brenda qëllimit të lejuar të kontrollit financiar;

23.3.2 mundësi hyrje në çdo Zonë të kontrolluar nga Koncesioneri;

23.3.3 mundësi hyrje në Sistem; dhe

23.3.4 mundësi hyrje në Personelin e Koncesionerit.

23.4 Koncesioneri do të zbatojë të gjitha masat dhe mjetet e monitorimit dhe procedurat e nevojshme për të matur dhe raportuar mbi performancën e Koncesionerit të Shërbimeve kundrejt Niveleve të Shërbimeve të aplikueshme në shkallën e mjaftueshme të hollësishme për të verifikuar përputhjen me Nivelet e Shërbimit.

23.5 Autoriteti do të përpiqet (por nuk është e detyrueshme) të sigurojë së paku 15 Ditë Pune njoftim për qëllimin e tij për të kryer një kontroll financiar.

23.6 Palët bien dakord që do të mbajnë kostot e tyre përkatëse dhe shpenzimet e shkaktuara lidhur me përputhshmërinë me detyrimet e tyre sipas këtij Neni, vetëm nëse kontrolli financiar identifikon një Mungesë materiale nga Koncesioneri në rastin e të cilit Koncesioneri do të rimbursojë Autoritetin për të gjitha kostot e arsyeshme të Autoritetit të shkaktuara gjatë kohës së kontrollit financiar.

23.7 Në qoftë se një kontroll financiar identifikon që Koncesioneri ka dështuar për të kryer detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshje në çdo mënyrë materiale, Palët do të bien dakord dhe zbatojnë një plan riparues. Në qoftë se dështimi i Koncesionerit lidhet me dështimin për të siguruar çdo informacion ndaj Autoritetit rreth Detyrimit Kontraktor ose kostove të Koncesionerit, atëherë plani riparues do të përfshijë një kërkesë për sigurimin e gjithë informacionit të tillë;

24. Regjistra dhe Raporte

Palët do të veprojnë në përputhje me dispozitat e Programit 2 (Kërkesat e Autoritetit) dhe 3 (Zgjidhja e Koncesionerit) lidhur me mbajtjen e të dhënave dhe bërjen e raporteve. Koncesioneri do ti sigurojë Autoritetit mbi një bazë të rregullt në mënyrë dhe formë të atillë dhe në mënyrë të shpeshtë siç mund të përcaktohet me hollësi nga Autoriteti.

25. Kontrolli i Ndryshimit

25.1 Çdo kërkesë për Ndryshim do t'i nënshtrohet Proçedurës së Kontrollit të Ndryshimit.

25.2 Nëse pas Ditës së Ekzekutimit hyn në fuqi, nxirret apo shtohet çfarëdo ligji, rregulloreje, urdhërese apo proçedure që ka fuqinë e ligjit në Republikën e Shqipërisë, dhe ndikon termat / afatet, përfshirë këtu datën e dorëzimit apo çmimin e këtyre dokumentave të identitetit por gjithmonë duke përjashtuar ndryshime të tilla të cilat ndikojnë në të gjitha bizneset në Shqipëri të tilla si ndryshime në ligjin për taksat, kushtet ose çmimi i dokumentave të identitetit në përputhje me këtë Marrëveshje do të shtohen në masën që është prekur Koncesioneri në përmbushjen e detyrimeve të tij të përcaktuara në këtë Marrëveshje sipas Proçedurës për Kontrollin e Ndryshimit.

26. Personeli

26.1 Autoriteti do të sigurojë se ai ka personel të mjaftueshëm dhe të bashkëpunojë me Koncesionerin për sa i përket zbatimit të Koncesionit dhe në përputhje me kërkesat e paraqitura në këtë Marrëveshje.

26.2 Autoriteti duhet të zëvendësojë menjëherë çdo punonjës i cili kryen veprime jo ligjore ose në kundërshtim me përshkrimin specifik të punës, detyrave dhe detyrimeve lidhur me zbatimin Kontraktor

26.3 Koncesioneri do të sigurojë që ai ka personel të mjaftueshëm në mënyrë që të plotësojë kërkesat e përcaktuara në këtë Marrëveshje.

26.4 Autoriteti mund ta drejtojë Koncesionerin për të përfunduar përfshirjen në sigurimin e Shërbimeve të çdo Personeli të Koncesionerit për të cilin Autoriteti mendon se përfaqëson një rrezik sigurie. Vendimi i Autoritetit do të jetë përfundimtar dhe ai nuk do të jetë i detyruar të sigurojë ndonjë arsye.

26.5 Secila Palë mund t'i sugjerojë Palës tjetër për të përfunduar përfshirjen në sigurimin e Shërbimeve të çdo Personeli të Koncesionerit për arsye të tjera përveç rrezikut për sigurinë. Pala përgjegjëse do të hetojë, vendosë dhe njoftojë në mënyrën e duhur Palën kërkuese mbi vendimin e saj brenda 30 ditëve.

26.6 Koncesioneri do të bëjë përpjekjet e tij më të mira për të siguruar vazhdimësinë e personelit dhe për të siguruar që shkalla e ndërrimit të Personelit Kryesor të përfshirë në sigurimin ose menaxhimin e shërbimeve është së paku po aq e mirë sa edhe standartet e industrisë për një Koncesioner që është duke operuar me Praktikën e Industrisë së Mirë për shërbime, zona dhe rrethana të njëjta.

26.7 Palët kanë rënë dakord për përcaktimin e Personelit Kryesor të listuar në Programin 13 (Personeli Kyç). Atje ku është e mundur, Koncesioneri do të japë së paku 3 muaj njoftim paraprak me shkrim rreth synimit të tij për të zëvendësuar Personelin Kyç.

26.8 Autoriteti në mënyrë të pa arsyetueshme nuk do të vonojë ose të tërheqë pëlqimin e tij për caktimin e një zëvendësimi për çdo Personel Kyç përkatës nga Koncesioneri.

26.9 Koncesioneri njeh që Personeli Kryesor është themelori për ofrimin e sigurimeve të duhura ndaj Autoritetit. Koncesioneri do të sigurojë që çdo zëvendësim do të jetë i kualifikuar dhe me përvojën e përshtatshme dhe tërësisht kompetent për të zbatuar detyrat e caktuara të Personelit Kyç të cilin ai ose ajo ka zëvendësuar.

26.10 Koncesioneri do të sigurojë që çdo personel kyç do të punojë për një periudhë kohe në performancën e Shërbimeve mbi baza me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme e mjaftueshme për të siguruar performancën përkatëse të duhur të rolit të atij personi. Një rol i tillë me kohë të plotë ose më kohë të pjesshme do të detajohet në Programin 13 (Personeli Kyç). Deri në shkallën që ai mund të veprojë kështu pa injoruar detyrimet e tij kontraktore dhe ligjore, Koncesioneri do të marrë të gjitha hapat e mjaftueshme për të siguruar që ai ruan shërbimet e Personelit Kyç. Gjatë Afatit Kohor të Kontratës Palët mund të bien dakord për të shtuar rolin e plote ose me kohë të pjesshme të një Personeli Kyç.

26.11 Koncesioneri do të sigurojë trajnime personeli në mënyrë që të dokumentojë proceset administrative dhe të ndihmojë në përdorimin, mirëmbajtjen dhe përvetësimin e njohurive të reja në lidhje me përdorimin, zbatimin dhe operimin e Sistemit. Kushtet e përgjithshme dhe specifike të trajnimit janë të rregulluara nga Programi 3 (Zgjidhja e Koncesionerit) i kësaj Marrëveshje.

27. Detyrimet e marra përsipër nga Sagem dhe nga AAEF

27.1 Sagem dhe AAEF bien dakord si vijon:

27.1.1 Ato të dyja do të mbeten të vetmet aksionere në Shoqërinë;

27.1.2 As Sagem e as AAEF nuk do të kalojnë, lënë peng apo tregtojnë aksionet e tyre në Shoqërinë Koncesionere pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit përveçse kur qoftë AAEF qoftë Sagem mund të shesin pjesëmarrjen e tyre tek njëra – tjetra me përjashtimin e vetëm se Sagem në të gjitha rastet do të ruajë të paktën 50.1% të aksioneve me të drejtë vote në Shoqërinë Koncesionere. Cilado transfertë do t'i njoftohet menjëherë Autoritetit;

27.1.3 Si Sagem edhe AAEF do të mbështesin plotësisht dhe do të jenë të përfshira në vënien në jetë të Koncesionit nga Shoqëria Koncesionere përgjatë gjithë Periudhës së Koncesionit, ndërmjet të tjerash edhe me anë të:

(i) sigurimit të burimeve të nevojshme (përfshirë edhe ato financiare), eksperitzës, teknologjisë dhe njohurive;

(ii) ekspertëve për çështje parësore të punësuar nga Shoqëritë Grup të tyre;

(iii) mbështetjes së vazhdueshme për Shoqërinë Koncesionere;

(iv) hyrjes tek mendimet dhe zhvillimet më bashkëkohore me rëndësi për Koncesionin;

27.2 Ndarja e autorizuar e kapitalit e Shoqërisë Koncesionere do të jetë dhe do të mbetet jo më pak se 5000000 (pesë milionë) Euro për gjithë Periudhën e Koncesionit shumë e kapitalit të së cilës do të arrihet brenda një maksimumi prej 6 (gjashtë) muajsh që nga Data Efektive e kësaj Marrëveshje.

27.3 Pavarësisht nga transferimi i kësaj Marrëveshje për tek Shoqëria Koncesionere, detyrimet e përcaktuara në këtë Nen 27 do të vazhdojnë të bien mbi Sagem dhe AAEF.

28 Garantimi dhe Mirëmbajtja

28.1 Sagem bie dakord që ai, për një vit pas përfundimit të kësaj Marrëveshje (Periudha e Garancisë), siç është tani, të sigurojë garancinë e Sistemit, pa ndonjë tarifë shtesë;

28.1.1 Mbulimi i Garancisë

Përgjegjësia e Sagem në lidhje me mirëmbajtjen kufizohet në pajisjet e Sistemit dhe programet e zbatuara kompjuterike të dorëzuara.

Garancia mbulon të gjithë gamën e njësive dhe programeve kompjuterike të dorëzuara nga Koncesioneri për të siguruar që Sistemi po operon normalisht.

Riparimi dhe zëvendësimi i përbërësve apo njësive me defekt do të sigurohet pa pagesë për të gjithë kohëzgjatjen e Periudhës së Garancisë.

Gjatë Periudhës së Garancisë, të gjitha veprimet për mirëmbajtjen e njësive dhe programeve kompjuterike kanë për synim që të ruajnë operativitetin e Sistemit, duke i korresponduar përcaktimeve të hollësishme mbi performancën të përcaktuara në Programet 2 dhe 3.

Gjatë Periudhës së Garancisë, Sagem do të sigurojë përditësimet e të gjitha programeve kompjuterike pa pagesë, duke përfshirë këtu ato në lidhje me sistemin operativ dhe me programet kompjuterike të zbatuara. Këto përditësime lidhen me modifikime që kompensojnë defekte të mundshme të gjetura gjatë operimit normal të sistemit. Këto modifikime sidoqoftë, nuk përfshijnë shtimin e veçorive të reja ekstra.

Gjatë Periudhës së Garancisë, zëvendësimi i pjesëve të këmbimit për pajisjet e ndjeshme e jo të tepërta do të bëhet i mundshëm për Autoritetin drejtpërdrejt nga Sagem në Mjedisin Qendror të Personalizimit. Nëse është e nevojshme, Sagem do të sigurojë edhe ndihmesën e nevojshme për të zëvendësuar përbërësit me defekt çka mund të përfshijë dërgimin e personelit të kualifikuar.

28.1.2 Kushtet e Garancisë

Garancia mbulon vetëm riparimin ose zëvendësimin për përbërës me defekt të Sistemit.

Garancia mbulon vetëm çështje mbi pajisjet që janë shkaktuar nga defektet në materialin apo punën njerëzore gjatë përdorimit të zakonshëm.

Kjo garanci nuk zbatohet për asnjë produkt mbi të cilin është ndryshuar, fshirë apo hequr informacioni origjinal identifikues apo nuk është përdorur apo paketuar saktësisht.

Sagem nuk është përgjegjës për e as nuk mbulon me garanci, çfarëdo humbje të të dhënave apo çfarëdo kostosh që i janë shkaktuar Autoritetit apo një pale të tretë të përfshirë nga Autoriteti që shoqërohet me përcaktimin e burimit të problemeve të sistemit apo me heqjen, shërbimin ose instalimin e produkteve të Sagem.

Është në përgjegjësinë e Autoritetit që të sigurojë mbështetje për çfarëdo të dhënash, programesh kompjuterike apo materialesh të tjera që mundtë jenë ruajtur apo mbajtur në njësi. Ka shumë mundësi që të tilla të dhëna, programe kompjuterike apo materiale të tjera do të humbin apo do të ri-formatohen gjatë punës dhe Sagem nuk do të jetë përgjegjës për asnjë dëmtim apo humbje të tillë.

28.1.3 Përjashtimi nga Garancia

Garancia nuk mbulon çfarëdo produkti të programeve kompjuterike që nuk përmbahet në zgjidhjen e Koncesionerit siç është në datën e përfundimit të Marrëveshjes.

Kjo garanci nuk mbulon asnjë dëm ndaj produkteve të Koncesionerit që rezulton nga instalimi i gabuar, aksidenti, abuzimi, keqpërdorimi, fatkeqësitë natyrore, furnizimi i pamjaftueshëm ose i tepërt me energji elektrike, kushtet anormale mjedisore apo mekanike, apo çdo çmontim, riparim apo modifikim i paautorizuar përveçse kur këto mund të shkaktohen nga Koncesioneri.

28.1.4 Riparimi dhe kthimi

Sistemi do t'i dorëzohet Autoritetit me pjesë këmbimi për pajisjet. Pjesët e këmbimit do të mbeten në pronësinë e Sagem dhe mund të përdoren vetëm në rast të zëvendësimit të pjesëve me defekt të Sistemit. Në fund të Periudhës së Garancisë, pjesët e papërdorura të Këmbimit do t'i dërgohen Sagem nga ana e Autoritetit.

Në rast të mosfunksionimit të njësive kompjuterike, Sagem do të kontaktohet për të përftuar një numër të Autorizimit për Kthim Material (RMA). Të gjitha materialet e kthyera duhet të kenë një numër të vlefshëm RMA. Ky numër është i nevojshëm për të siguruar gjurmimin e duhur dhe dorëzimin e materialeve të kthyera në fabrikë.

Nëse artikujt janë nën garanci, Sagem do të dërgojë me e-mail numrin tuaj RMA menjëherë. Dokumenti i dërguar me e-mail do të përfshijë edhe adresën e Qendrës sonë të Riparimeve dhe udhëzime shtesë të dërgimit.

Konçesioneri ruan të drejtën që të refuzojë dërgimet që nuk kanë një numër të autorizuar RMA. Dërgesat e refuzuara do t'i kthehen dërguesit.

28.2 Nëse kërkohet nga Autoriteti, Sagem do të sigurojë mirëmbajtjen e përvitshme siç përcaktohet në Nenin 28.1 deri në katër vjet pas Periudhës së Garancisë për një çmim fiks prej 145,639,970 lekë në vit (duke përjashtuar TVSH);

28.3 Pavarësisht nga transferimi i kësaj Marrëveshje tek Shoqëria Konçesionere, detyrimet e përcaktuara në këtë Nen 28 do të vazhdojnë të bien mbi Sagem.

29 Shëndeti dhe siguria

Konçesioneri njeh se ai do të veprojë në përputhje me të gjitha rregullat statutore të zbatueshme lidhur me shëndetin dhe sigurinë.

30 Barazia dhe Diversiteti

Konçesioneri do të, dhe do të sigurohet që Personeli Konçesioner do të veprojë në përputhje me çdo legjislacion anti-diskriminues të zbatueshëm siç mund të jetë shtuar kohë pas kohe.

31 Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale

31.1 Kjo Marrëveshje nuk përcakton ndonjë të Drejtë të Pronësisë Intelektuale (IPR) të secilës palë ose të liçensuarve të tyre përkatës në ekzistencë në Datën Efektive dhe për mënjanimin e dyshimit, përveç se siç është paraqitur shprehimisht në këtë Marrëveshje:

31.1.1 Autoriteti nuk do të njohë ndonjë të drejtë, titull ose interes në ose ndaj Programit kompjuterik të Konçesionerit, IPR-ve të Konçesionerit ose Programeve kompjuterike të Palëve të treta, dhe

31.1.2 Konçesioneri nuk do të fitojë ndonjë të drejtë, titull ose interes në ose ndaj Sfondit të IPR-ve të Autoritetit.

32 Liçencat e dhëna nga Konçesioneri

32.1 Duke iu nënshtruar Nenit 32.2, Konçesioneri me anën e kësaj garanton, ose do të autorizojë dhënien e drejtpërdrejtë tek autoriteti të një liçense të përhershme, të transferueshme, të gjithanshme, të lirë, jo-ekskluzive për të përdorur Programin kompjuterik të Palëve të Treta, Programin kompjuterik të Konçesionerit dhe IPR-të e

Koncesionerit për çdo qëllim që lidhet me të ose në të kundërt lidhur me Shërbimet ose në ushtrimin e punës apo funksionit të Autoritetit duke përfshirë:

32.1.1 Të drejtën për të nën-licensuar sa më lart, për Koncesionerin Zëvendësues ose për çdo palë tjetër të tretë që siguron këto shërbime për Autoritetin; dhe

32.1.2 Të drejtën për të caktuar dhe transferuar licencën tek një organ pasardhës që kryen funksionet e Autoritetit.

32.2 Autoriteti nuk do të kthejë, projektojë, çhartojë, çmontojë apo kopjojë Programin Kompjuterik të Palës së Tretë, Programin Kompjuterik të Koncesionerit dhe Sfondin e IPR-ve të Koncesionerit; Autoriteti as nuk do të modifikojë, krijojë një punë të ardhur si rrjedhojë apo përdorë ndryshe Programin Kompjuterik të Palës së Tretë, Programin Kompjuterik të Koncesionerit dhe Sfondin e IPR-ve të Koncesionerit, përveçse siç deklarohet në këtë Nen 32.

32.3 Autoriteti nuk do të heqë, vështirësojë apo ndryshojë çfarëdo njoftimi mbi patenta, marka tregtare, marka shërbimi, të drejta të autorit apo të drejta të tjera pronësie që lidhen me Programin Kompjuterik të Palës së Tretë, Programin Kompjuterik të Koncesionerit dhe Sfondin e IPR-ve të Koncesionerit. Autoriteti do të njoftojë menjëherë Koncesionerin për çdo përdorim të paautorizuar të Programin Kompjuterik të Palës së Tretë, Programin Kompjuterik të Koncesionerit dhe Sfondin e IPR-ve të Koncesionerit që vjen në dijeninë e Autoritetit.

Autoriteti do të sigurojë që cilado palë e tretë së cilës i janë dhënë licenca sipas Nenit 32.1 të veprojë në përputhje me Nenet 32.2 dhe 32.3.

32.4 Në lidhje me Programin Kompjuterik të Palës së Tretë, në se Koncesioneri nuk mund të përftojë për licencën e Autoritetit në përputhje me termat e përcaktuara në Nenin 32.1, Koncesioneri ose do të përshkruaj më me hollësi licencën e tanishme të përftuar ose do të këshillohet me Autoritetin mbi atë nëse të drejtat që mund të përftohen janë gjithsesi të pranueshme për Autoritetin ose nëse Koncesioneri duhet të kërkojë të përdorë një ofrues alternativ të programit kompjuterik.

33 Licencat e dhëna nga Autoriteti

33.1 Autoriteti i jep Koncesionerit një licencë të heqshme, joekskluzive, të patransferueshme, të vazhduar / royalty-free, gjatë Afatit vetëm në masën që Autoriteti quan të nevojshme për kryerjen e shërbimeve për të përdorur:

33.1.1 Bazën e të dhënave prej nga të drejtat përkatëse janë transferuar tek Autoriteti në përputhje me Nenin 34;

33.1.2 Dokumentacionin, proçeset dhe proçedurat e Autoritetit;

33.1.3 Të Dhënat e Autritetit; dhe

33.1.4 Çdo IPR tjetër të Sfondit të Autoritetit.

33.2 Licenca e dhënë Koncesionerit në Nenin 33.1:

33.2.1 përfshin të drejtën për të dhënë nën-licenca ndaj Nën-kontraktorëve, më kushte jo më të favorshme se sa licenca e dhënë nga Koncesioneri sipas Nenit 33.1 me kusht që çdo Nën-kontraktor përkatës ka qenë aprovuar nga Autoriteti në përputhje me Nenin 21.1 dhe ka hyrë në një detyrim për konfidencialitet me Koncesionerin me të njëjtat kushte siç janë përcaktuar në Nenin 43 (Konfidencialiteti); dhe

33.2.2 jepet tërësisht deri në shkallën që Autoriteti e konsideron të nevojshme për të kryer Shërbimet në përputhje me këtë Marrëveshje. Koncesioneri nuk do të, dhe do të autorizojë që Nën-kontraktori nuk do të, të përdorë materialet e licencuara të identifikuara në Nenin 33.1 për ndonjë qëllim tjetër ose për interes / përfitim të ndonjë personi tjetër përveç se Autoritetit.

33.3 Asnjëra Palë nuk do të këtë ndonjë të drejtë për të përdorur ndonjë nga emrat e Palës tjetër, logot ose markat e shitjes ose ndonjë prej produkteve të tij pa pëlqimin paraprak me shkrim të palës tjetër.

33.4 Në rast të ndërprerjes ose skadimit të kësaj Marrëveshje, licencës referuar Nenit 33.1, çdo nën-licencë e dhënë në përputhje me Nenin 33.2 do të ndërpritet automatikisht dhe Koncesioneri do të dorëzojë menjëherë tek Autoriteti të gjitha materialet e licencuara tek Koncesioneri ose Nën-kontraktorët e tij sipas Neneve 33.1, ose 33.2 nën pronësinë ose kontrollin e Koncesionerit ose Nën-kontraktorit, sipas opsionit të vetë Autoritetit, të shkatërrojë materiale të tilla të licencuara në përputhje me çdo instruksion lëshuar nga Autoriteti në atë kohë, më një shkatërrim i cili do të vërtetohet me shkrim nga përfaqësuesit e Koncesionerit tek Autoriteti menjëherë paskëtaj.

34 Përcaktimi i IPR-ve në Bazën e të Dhënave

34.1 Me anën e kësaj Koncesioneri përcakton tek Autoriteti, me titull të plotë garancie, titullin dhe të gjitha te drejtat dhe interesin në Bazën e të Dhënave duke përfshirë të gjitha të drejtat e Pronësisë Intelektuale në të ose do të ndikojë që pronari i parë i Bazës së të Dhënave i përcakton ato ndaj Autoritetit mbi të njëjtat baza.

34.2 Përcaktimi sipas Nenit 36.1 ose do të bëhet i vlefshëm në Bazën e të Dhënave ose si një përcaktim i ri i të drejtave në të ardhmen që do të bëhen të vlefshme menjëherë sapo të bëhet ekzistuese Baza e të Dhënave, kur të jetë e përshtatshme.

34.3 Koncesioneri do të tërhiqet ose autorizojë heqjen pa kushte dhe të parevokueshme të të gjithë të drejtave morale të së drejtës së autorit që janë të përfshira në Bazën e të Dhënave të përcaktuara për Autoritetit sipas kësaj Marrëveshje.

34.4 Pa paragjykuar Nenin 61, në qoftë se do të kërkohet nga Autoriteti, Koncesioneri menjëherë do të përmbushë të gjitha dokumentat pa detyrim ndaj Autoritetit dhe të bëjë veprime të tilla të mëtejshme (ose të autorizojë përmbushje të tillë ose veprime të tilla) nëse Autoriteti mund të kërkojë të perfeksionojë përcaktimin sipas Nenit 34.1.

35 Përcaktimi i IPR-ve të Posaçme të Projektit dhe i Programeve kompjuterike të Shkruar Posaçërisht

35.1 Në fund të Periudhës së Koncesionit, Koncesioneri përcakton tek Autoriteti, me titull të plotë garancie, titullin dhe të gjitha të drejtat dhe interesin mbi IPR-të e Posaçme të Projektit dhe Programin kompjuterik të shkruar posaçërisht duke përfshirë të gjitha të drejtat e Pronësisë Intelektuale në të ose do të ndikojë që pronari i parë i IPR-ve të Posaçme të Projektit dhe Programit kompjuterik të shkruar posaçërisht t'i përcaktojë ato ndaj Autoritetit mbi të njëjtat baza.

35.2 Caktimi sipas Nenit 37.1 do të hyjë në fuqi në datën e mbarimit të Periudhës së Koncesionit.

35.3 Koncesioneri do të tërhiqet ose autorizojë heqjen pa kushte dhe të parevokueshme të të gjithë të drejtave morale për çdo të drejte të autorit të përfshira në IPR-të e Posaçme të Projektit të përcaktuar për Autoritetin sipas kësaj Marrëveshje.

35.4 Pa paragjykuar Nenin 60 (**Ndarja**), në qofte se do të kërkohet të veprohet kështu nga Autoriteti, Koncesioneri menjëherë pa ndonjë tarifë ndaj Autoritetit do të ekzekutojë të gjitha dokumentat dhe të kryejë të gjitha veprimet e tjera të hollësishme (ose të autorizojë një përmbarim të tillë dhe veprime të tilla) siç mund t'i kërkojë Autoriteti për të perfeksionuar përcaktimin sipas Nenit 35.1.

35.5 Përveç të drejtave të licencës të përcaktuara në Nenin 33, Autoriteti do t'i japë Koncesionerit në çdo rast me pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit një licencë jo-ekskluzive, të patransferueshme, dhe me status madhor të revokueshëm të IPR-ve të Posaçme të Projektit dhe Programit kompjuterik të Shkruar Posaçërisht për të aftësuar krijimin e punëve për klientët e tjerë që janë adaptuar ose kanë rrjedhur nga IPR-të e Posaçme të Projektit dhe Programi kompjuterik i Shkruar Posaçërisht.

35.6 Koncesioneri do t'i japë Autoritetit Programin kompjuterik të Shkruar posaçërisht në të dyja format sipas Kodit të Burimit dhe Kodit binar brenda 14 ditëve të krijimit dhe datën e mbarimit të Periudhës së Koncesionit në media që është arsyeshëm e pranuar prej Autoritetit.

36 Të dhënat e Autoritetit

36.1 Koncesioneri nuk do të fshijë apo heqë çfarëdo lajmërimesh mbi pronësinë që përmbahen brenda apo në lidhje me Të Dhënat e Autoritetit.

36.2 Koncesioneri nuk do të ruajë, kopjojë, përhapë apo përdorë të Dhënat e Autoritetit përveçse kur janë të nevojshme për përmbushjen nga ana e Koncesionerit të detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshje gjatë Afatit të kësaj Marrëveshje apo siç është autorizuar ndryshe shprehimisht me shkrim nga Autoriteti.

36.3 Në masën që të Dhënat e Autoritetit mbahet dhe / ose proçesohet nga Koncesioneri, Koncesioneri do të furnizojë këto të Dhëna të Autoritetit ndaj këtij të fundit siç do të kërkohet nga Autoriteti në formatin e përcaktuar me hollësi në Programin 2 (Kërkesat e

Autoritetit), Programin 3 (Zgjidhja e Koncesionerit) dhe / ose në Programin 22 (Menaxhimi i Daljes).

36.4 Mbi marrjen apo krijimin nga ana e Koncesionerit të cilavedo të Dhëna të Autoritetit dhe gjatë çfarëdo mbledhje, proçesimi, ruajtje dhe transmetimi nga Koncesioneri të çfarëdo të Dhënash të Autoritetit, Koncesioneri do të ndërmarrë gjithë masat parandaluese të nevojshme për të ruajtur integritetin e të Dhënave të Autoritetit si edhe për të parandaluar çfarëdo korrupsioni apo humbje të të Dhënave të Autoritetit.

36.5 Koncesioneri do të kryejë proçese të sigurta mbështetëse për të gjitha të Dhënat e Autoritetit dhe do të sigurojë që sisteme të përditësuara mbështetëse të ruhen jashtë linjës / mjedisit në përputhje me Planin e Vazhdimësisë së Punës / Biznesit. Koncesioneri do të sigurojë që sisteme të tilla mbështetëse të jenë të disponueshme për Autoritetin në çdo kohë sipas kërkesës dhe t'i shpërndahen Autoritetit në jo më pak se sa intervale dymujore.

36.6 Koncesioneri do të sigurojë që çdo sistem mbi të cilin Koncesioneri mban çfarëdolloj të Dhënash të Autoritetit, duke përfshirë të dhënat mbështetëse, është një sistem i sigurtë që përputhet me Programin 2 (Kërkesat e Autoritetit) dhe Programin 3 (Zgjidhja e Koncesionerit) të kësaj Marrëveshje.

36.7 Nëse të Dhënat e Autoritetit korruptohen, humbin apo degradojnë mjaftueshëm si rrjedhojë e Pazotësisë së Koncesionerit aq sa të bëhen të papërdorshme, Autoriteti mund:

36.7.1 të kërkojë që Koncesioneri (me shpenzimet e Koncesionerit) për të rimëkëmbur apo siguruar rimëkëmbjen e të Dhënave të Autoritetit dhe Koncesioneri do të bëjë kështu sa më shpejt që të jetë e praktikueshme por jo më vonë se sa pesë (5) ditë pune ose çdo periudhë tjetër e rënë dakord mes Palëve; dhe / ose

36.7.2 të rimëkëmbë vetë apo të sigurojë rimëkëmbjen e të Dhënave të Autoritetit dhe do të ripaguhet nga Koncesioneri për çdo shpenzim të arsyeshëm që është shkaktuar në veprimin në këtë mënyrë.

36.7.3 të paguajë sanksionet përkatëse të përcaktuara në Programin 11.

36.8 Nëse në çdo kohë, Koncesioneri dyshon apo ka arsye për të besuar se të Dhënat e Autoritetit janë apo ka të ngjarë të jenë korruptuar, humbur apo degraduar mjaftueshëm në çfarëdo mënyrë e për çfarëdo arsye, më pas Koncesioneri do të njoftojë Autoritetin menjëherë dhe do ta informojë Autoritetin mbi veprimin rregullues që Koncesioneri propozon të ndërmerret.

37 Mbrojtja e të Dhënave Personale

37.1 Në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e Palëve sipas kësaj Marrëveshje, Palët bien dakord që Autoriteti është pronar dhe kontrollues i të Dhënave Personale dhe që Koncesioneri është duke proçesuar të Dhëna Personale në emër të Autoritetit.

37.2 Koncesioneri:

37.2.1 do të proçesojë të Dhënat Personale vetëm në përputhje me udhëzimet nga Autoriteti (të cilat mund të jenë udhëzime të posaçme apo udhëzime të një natyre të përgjithshme siç përcaktohen në këtë Marrëveshje ose siç janë njoftuar ndryshe nga Autoriteti ndaj Konçesionerit gjatë Termit / Afatit);

37.2.2 do të proçesojë të Dhënat Personale vetëm në masën, e në një mënyrë të tillë, siç është e nevojshme për sigurimin e Shërbimeve ose siç kërkohet nga Ligji apo çdo organ rregullues;

37.2.3. do të vërë në jetë masa të përshtatshme teknike dhe organizative për të mbrojtur të Dhënat Personale kundër proçesimit të paautorizuar apo të paligjshëm si edhe kundër humbjes aksidentale, shkatërrimit, dëmtimit, ndryshimit apo përhapjes. Këto masa do të jenë të përshtatshme për dëmin i cili mund të vijë si rrjedhojë nga proçesimi i paautorizuar apo i paligjshëm, humbja aksidentale, shkatërrimi apo dëmtimi ndaj të Dhënave Personale dhe do të kishte parasysh natyrën e të Dhënave Personale të cilat janë për tu mbrojtur.

37.2.4. do të ndërmarrë hapa të arsyeshëm për të siguruar seriozitetin e cilitdo nga Personeli i Konçesionerit që do të ketë hyrje në të Dhënat Personale;

37.2.5 do të përftojë pëlqimin paraprak me shkrim nga Autoriteti me qëllim që të transferojë të Dhënat Personale ndaj cilitdo Nën – kontraktor apo filial për sigurimin e Shërbimeve;

37.2.6 do të sigurojë që i gjithë Personeli i Konçesionerit të cilit i kërkohet të ketë hyrje në të Dhënat Personale të jetë i informuar mbi natyrën konfidenciale të të Dhënave Personale dhe të përputhet me detyrimet e përcaktuara në këtë Nen 37.2.7;

37.2.7 do të sigurojë që asnjë person nga Personeli i Konçesionerit të mos publikojë, përhapë apo shpërndajë çfarëdo të Dhëne Personale ndaj cilësdo palë të tretë përveçse kur është i urdhëruar me shkrim për të vepruar kështu nga Autoriteti;

37.2.8 do të njoftojë Autoritetin (brenda 5 ditësh pune) nëse merr një kërkesë nga një qytetar për ta hyrë në të Dhënat Personale të atij personi;

37.2.9 do t'i sigurojë Autoritetit bashkëpunimin dhe ndihmesën e vet të plotë në lidhje me çfarëdo ankese apo kërkese të bërë, duke përfshirë këtu përmes:

37.2.9.1 sigurimit ndaj Autoritetit hollësi të plota të kërkesës apo ankesës;

37.2.9.2 sigurimit ndaj Autoritetit çfarëdo të Dhënash Personale që ai ka në lidhje me një Subjekt të të Dhënave (brenda kohës së kërkuar nga Autoriteti); dhe

37.2.9.3 sigurimit ndaj Autoritetit me çdo informacion të nevojshëm të kërkuar nga Autoriteti;

37.2.10 do të lejojë Autoritetin (duke iu nënshtruar zotimeve të arsyeshme e të përshtatshme për konfidencialitet), do të kontrollojë financiarisht dhe inspektojë,

në përputhje me Nenin **Error! Reference source not found.** (Kontrollet Financiare), veprimtaritë e proçesimit të të dhënave të Koncesionerit (dhe / ose ato të agjentëve, aksesorëve apo Nën – kontraktorëve të tij) dhe do të veprojë në përputhje me të gjitha kërkesat e arsyeshme apo udhëzimet nga Autoriteti për ta mundësuar Autoritetin që të verifikojë dhe / ose sigurojë që Koncesioneri është në përputhje të plotë me detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshje;

37.2.11 do të sigurojë një përshkrim të shkruar të metodave teknike dhe organizative të përdorura nga Koncesioneri për proçesimin e të Dhënave Personale (brenda kohës së kërkuar arsyeshmërisht nga Autoriteti); dhe

37.2.12 nuk do të proçesojë të Dhëna Personale jashtë Shqipërisë pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit.

37.3 Koncesioneri do të veprojë në çdo kohë në përputhje me legjislacionin mbi Mbrojtjen e të Dhënave dhe nuk do t'i kryejë detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshje në një mënyrë të tillë që të shkaktojë që Autoriteti të shkelë cilëndo nga detyrimet e zbatueshme të tij sipas legjislacionit mbi Mbrojtjen e të Dhënave.

38 Detyrime të Posaçme të Autoritetit

38.1 Autoriteti do të jetë përgjegjës për sigurinë e jashtme të Mjedisit Qendror të Personalizimit, 24 orë në ditë, duke siguruar roje të armatosura në përputhje me standartet e zbatuara për Objektet e Rëndësisë së Veçantë.

38.2 Autoriteti do të sigurojë personelin e nevojshëm me aftësi dhe kualifikim për Mjediset Administrative Rajonale dhe Zyrat e përkohshme të Aplikimeve të përcaktuara nga Koncesioneri në përputhje me afatet dhe kushtet e siguruara në Programin 2 (Kërkesat e Autoritetit) dhe Programin 3 (Zgjidhja e Koncesionerit).

38.3 Autoriteti do të rishikojë të gjitha dokumentat (si psh projektet, planet, kërkesat) e paraqitura nga Koncesioneri për të kërkuar miratimin e mëparshëm të Autoritetit, jo më vonë se 10 ditë pune pas marrjes së njoftimit nga Autoriteti, përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë Marrëveshje, e do të dërgojë miratimin e tij ose do të japë komentet e veta me shkrim mbi dokumente të tilla.

38.4 Autoriteti i garanton Koncesionerit aksesin në të dhënat e Sistemit ekzistues 'Papillon' AFIS. Autoriteti do të vërë në dispozicion një rrjet telekomunikacioni ndërmjet kësaj Police të re AFIS dhe atyre të Pikave Kufitare apo Stacionet e Zyrave të Policisë. Autoriteti do të dedikojë burimet e nevojshme nga ana e policisë.

38.5 Do të sigurojë një gjerësi vale të përshtatshme falas të dedikuar brenda sistemit të komunikimit Datacom.

38.6 Do të sigurojë linja të energjisë elektrike për Mjedisin Qendror të Personalizimit dhe për Ndërtesën Mbështetëse / Back-Up, si edhe furnizim me energji elektrike të pandërprerë (24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë) me një linjë emergjence mbështetëse. Kosto e energjisë elektrike për Mjedisin Qendror të Personalizimit do të përballohet nga Koncesioneri për të gjithë Periudhën e Koncesionit.

38.7 Autoriteti do të nënshkruajë të gjitha Çertifikatat e Pranimit brenda 15 ditëve pune pas plotësimit të suksesshëm të provave të Pranimit.

39 Detyrime të Përgjithshme të Autoritetit

39.1 Autoriteti do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të bërë kartat e identitetit në Shqipëri të detyrueshme për të gjithë aplikantët mbi 16 vjeç. Autoriteti do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim që të detyrojë aplikantët që të aplikojnë për karta identiteti në rast të ndryshimit të gjendjes së tyre civile;

39.2 Duke iu nënshtruar miratimit të ligjit për Koncesionin e Dokumentave të identifikimit, Autoriteti do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar detyrimin e shtetasve shqiptarë që të zëvendësojnë pasaportën e tyre të tanishme me një Pasaportë të re elektronike brenda dy vjetësh në vijim të Datës së Pikësynimit 5 të kësaj Marrëveshje në lidhje me Kartat e Identitetit dhe të Pikësynimit 6 të kësaj Marrëveshje në lidhje me Pasaportat.

39.3 Autoriteti do të sigurojë që të paktën një zyrtar i Autoritetit të veprojë në çdo kohë për rregjistrimin e të dhënave të aplikantëve për karta identiteti në çdo RAP, si edhe që të kontrollojë dhe autorizojë (çertifikojë) me shkrim, në emër të Autoritetit, çdo formular aplikimi për dokument identiteti si edhe dokumentat mbështetëse në përputhje me dokumentat dhe proçedimet e kërkuara.

39.4 Autoriteti do të sigurojë që Koncesioneri të furnizohet me të dhëna dhe informacione me rëndësi për plotësimin e detyrimeve të Koncesionerit sipas kësaj Marrëveshje dhe / ose që kërkohet për qëllimin e menaxhimit, operimit dhe zhvillimit të Marrëveshjes dhe të informojë Koncesionerin mbi çdo ndryshim apo shtim dhe të sigurojë kopje të të dhënave dhe informacioneve të tilla për Koncesionerin siç mund arsyeshmërisht të kërkohet;

39.5 Autoriteti do të përfundojë dhënien e Mjedisit Qendror të Personalizimit, Ndërtesës Mbështetëse / Back-Up dhe të Mjediseve Rajonale Administrative ndaj Koncesionerit përpara fillimit Datës së Fillimit, në përputhje me këtë Marrëveshje.

39.6 Autoriteti do të kryejë dorëzimin e Ndërtesës Mbështetëse dhe Mjediseve Adminstrative Rajonale në favor të Koncesionerit jo më vonë se 3 muaj pas Datës Efektive, në përputhje me këtë Marrëveshje dhe me kërkesat e përshkruara në Programin 8 (Detyrime Shtesë të Autoritetit).

40 Plani i Rimëkëmbjes nga Dëmtimet e Rënda

40.1 Palët do të veprojnë në përputhje me dispozitat e Planit të Rimëkëmbjes nga Dëmtimet e Rënda dhe Koncesioneri do të sigurojë që është i aftë të vërë në jetë Planin e Rimëkëmbjes nga Dëmtimet e Rënda në përputhje me termat / afatet e tij. Plani i Rimëkëmbjes nga Dëmtimet e Rënda do të sigurohet nga Koncesioneri për Autoritetin brenda 3 muajsh nga Data Efektive.

40.2 Koncesioneri do të provojë Planin e Rimëkëmbjes nga Dëmtimet e Rënda rregullisht (dhe në çdo rast jo më pak se sa një herë në çdo periudhë prej 12 muajsh). Duke iu nënshtruar

Nenit 40.3, Autoriteti mund t'i kërkojë Koncesionerit që të kryejë prova shtesë mbi Planin e Rimëkëmbjes nga Dëmtimet e Rënda atje ku Autoriteti quan se kjo është e nevojshme, përfshirë këtu kur ka pasur çfarëdo ndryshimi në Shërbime apo në çfarëdo proçesesh pune bazë, ose në çdo rast i cili mund të rrisë gjasat e nevojës për të vënë në jetë Planin e Rimëkëmbjes nga Dëmtimet e Rënda.

40.3 Nëse Autoriteti kërkon një provë shtesë të Planit të Rimëkëmbjes nga Dëmtimet e Rënda ai do t'i dërgojë Koncesionerit njoftim me shkrim dhe Koncesioneri do të kryejë provën në përputhje me kërkesat e Autoriteti dhe me dispozitat përkatëse të Planit të Rimëkëmbjes nga Dëmtimet e Rënda. Kostot e Koncesionerit për provën shtesë do të përballohen nga Autoriteti përveçse kur Plani i Rimëkëmbjes nga Dëmtimet e Rënda dështon provën rast në të cilin kostot e Koncesionerit që nuk e kaloi provën për atë provë që nuk u kalua do të përballen nga Koncesioneri.

40.4 Në vijim të çdo prove, Koncesioneri do t'i dërgojë Autoritetit një raport me shkrim ku të përmbledhë rezultatet e provës dhe do të vërë në jetë menjëherë çdo veprim apo masë rregulluese të cilën Autoriteti e vlerëson se është e nevojshme si një rrjedhim i atyre provave.

40.5 Koncesioneri do të marrë përsipër vlerësime të rregullta të rrezikut në lidhje me sigurimin e Shërbimeve jo më pak se sa një herë në çdo gjashtë muaj dhe do të sigurojë rezultatet dhe çdo rekomandim i bashkëlidhur, të këtyre vlerësimeve të rrezikut t'i jepen Autoritetit menjëherë me shkrim në vijim të çdo rishikimi.

41 Forca Madhore – *Force Majeure*

41.1 Pasoja e Ngjarjeve të Forcës Madhore

Në rastin e ndodhjes së çfarëdo Ngjarje të Forcës Madhore, do të zbatohen sa vijon:

41.1.1 nuk do të ketë asnjë përfundim të kësaj marrëveshje përveçse siç parashikohet në Nenin 50 në vazhdim;

41.1.2 në rastin kur një Ngjarje e Forcës Madhore ndodh përpara Datës Efektive, afati për arritjen e Datës Efektive do të shtrihet me periudhën për të cilën Ngjarja e Forcës Madhore do të vazhdojë;

41.1.3 në rastin kur një Ngjarje e Forcës Madhore ndodh pas Datës Efektive, Periudha e Koncesionit do të zgjatet për kohëzgjatjen e një Ngjarje të tillë të Forcës Madhore;

41.2 Përveçse për dispozitat e Nenit 25.2, Autoriteti mund që në Marrëveshje me Koncesionerin t'i rimbursojë kostot e Focrës Madhore Koncesionerit në monedhë apo të kompensojë Koncesionerin për të tilla kosto me anë të shtrirjes së përshtatshme të Periudhës së Koncesionit.

42 Dëmshpërblimi

42.1 Autoriteti

Autoriteti do të dëmshpërblejë, mbrojë dhe ruajë Koncesionerin të pacënuar nga ndonjë dhe çdo proçedim, veprim, pretendim të palës së tretë për humbje, dëm dhe shpenzim të çfarëdo lloji dhe natyre që lind nga shkelja nga ana e Autoritetit, zyrtarëve, nëpunësve dhe agjentëve të tij, të ndonjë detyrimi të Autoritetit sipas kësaj Marrëveshjeje, përveçse në shkallën që një pretendim i tillë ka lindur për shkak të shkeljes nga Koncesioneri të ndonjë prej detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

42.2 Koncesioneri

Koncesioneri do të dëmshpërblejë dhe do të vazhdojë të dëmshpërblejë Autoritetin gjatë Periudhës së Koncesionit nga dhe kundër ndonjë dhe çdo procedimi, veprimi, pretendimi të palës së tretë për humbje, dëm, dhe shpenzim të çfarëdo lloji dhe natyre që lind nga shkelja nga ana e Koncesionerit, nëpunësve, nëpunësve të afërt dhe agjentëve të tij, të ndonjë detyrimi të Koncesionerit sipas kësaj Marrëveshjeje, përveçse në shkallën që kjo humbje ose ky dëm lind nga shkelja e ndonjë dispozite të shprehur të kësaj Marrëveshjeje nga Autoriteti ose ndonjë Organ Shtetëror ose ndonjë veprim ose mosveprim i qëllimshëm i Autoritetit ose i ndonjë Organi Shtetëror;

42.3 Në çdo kohë gjatë dhe pas mandatit, me anë të një kërkese me shkrim, Koncesioneri do të dëmshpërblejë Autoritetin dhe do të vazhdojë të dëmshpërblejë Autoritetin kundrejt të gjitha humbjeve, dëmeve, kostove ose shpenzimeve dhe përgjegjësive të tjera (duke përfshirë tarifat ligjore) të shkaktuara nga, të dhëna për ose të rëna dakord për t'u paguar nga Autoriteti, të cilat lindin nga një:

42.3.1 Pretendim IPR;

42.3.2 Pretendim për Humbje Fizike;

42.3.3 Pretendim për Humbjen e të Dhënave;

42.3.4 Pretendim të Palës së Tretë për Humbje Fizike; dhe

42.3.5 DPA/Konfidencialiteti/Pretendimi i Garancisë; dhe

42.4 Autoriteti bie dakord që:

42.4.1 Do të njoftojë Koncesionerin me shkrim në lidhje me ndonjë Pretendim IPR;

42.4.2 Do të lejojë Koncesionerin të realizojë të gjitha negociatat dhe procedimet dhe do t'i ofrojë Koncesionerit atë asistencë të arsyeshme të kërkuar nga Koncesioneri, secila me shpenzimin e Koncesionerit, në lidhje me Pretendimin IPR; dhe

42.4.3 Pa u këshilluar më parë me Koncesionerin, nuk do të bëjë pranime në lidhje me Pretendimin mbi një IPR.

42.5 Koncesioneri do të shqyrtojë dhe mbrojë pretendimin IPR duke përdorur me kujdes konsulencën kompetente dhe në mënyrë të tillë që të mos dëmtojë reputacionin e Autoritetit.

42.6 Koncesioneri nuk do të zgjidhë ose cënojë ndonjë Pretendim IPR pa miratimin paraprak me shkrim të Autoritetit (që nuk duhet të tërhiqet ose shtyhet në mënyrë të paarsyeshme).

42.7 Nëse ngrihet një pretendim IPR ose nëse Koncesioneri parashikon që mund të ngrihet një Pretendim IPR, Koncesioneri, me shpenzimet e veta dhe me zgjedhjen e vetme, mundet ose:

42.7.1 t'i sigurojë Autoritetit të drejtën për të vazhduar të përdorë artikullin përkatës që i nënshtrohet Pretendimit IPR; ose

42.7.2 të zëvendësojë ose modifikojë artikullin përkatës me zëvendësues moszbatues, me kusht që:

42.7.1.1 performanca dhe operimi i artikullit të zëvendësuar ose të modifikuar të jenë të paktën të barazvlefshme me performancën dhe operimin e zërit fillestar;

42.7.1.2 artikulli i zëvendësuar ose i modifikuar nuk ka pasoja serioze për ndonjë Shërbim tjetër ose për Sistemin;

42.7.3 nuk ka kosto shtesë për Autoritetin; dhe

42.7.4 kushtet e Marrëveshjes do të aplikohen për Shërbimet e zëvendësuara ose të modifikuara.

42.8 Nëse Koncesioneri zgjedh të modifikojë ose zëvendësojë një zë sipas Nenit 42.7.2 ose të sigurojë një licencë në përputhje me Nenin 42.7.1, por kjo nuk ka shmangur ose zgjidhur Pretendimin IPR, atëherë Autoriteti mund t'i japë fund Marrëveshjes me anë të një njoftimi me shkrim me efekt të menjërheshëm dhe pa cënuar dëmshpërblimin e parashtruar në Nenin 42.1 Koncesioneri do të jetë përgjegjës për të gjitha kostot e arsyeshme dhe të pashmangshme të zërave dhe/ose shërbimeve zëvendësuese, duke përfshirë kostot shtesë në implementimin dhe ruajtjen e zërave zëvendësues.

42.9 Dispozitat e Klauzolave 42.1 deri 42.8 (përfshirë) nuk zbatohen në lidhje me ndonjë Pretendim IPR të shkaktuar nga:

42.9.1 Ndonjë përdorim nga ose në emër të Autoritetit të Softuerit ose përdorim të Programit Kompjuterik të Autoritetit nga ose në emër të Koncesionerit, në çdo rast në kombinim me ndonjë zë që nuk është dhënë sipas kësaj Marrëveshjeje; ose

42.9.2 Përdorimi nga Autoriteti i Progamit Kompjuterik ose përdorimi i Porgramit Kompjuterik të Autoritetit nga Koncesioneri, në çdo rast në një mënyrë që nuk duhet të tregohet në mënyrë të arsyeshme nga Përshkrimi i Shërbimeve ose dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

42.10 Pakësimi i Humbjes

Pala që shkakton një shkelje të kësaj Marrëveshjeje do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të pakësuar humbjen, dëmin që ka ndodhur, me kusht që pakësimi i humbjes ose lehtësimi i dëmit të mund të bëhen pa vështirësi ose kosto të paarsyeshme.

43 Konfidencialiteti

43.1 Përveçse në shkallën e përcaktuar në këtë Neni ose kur zbulimi i informacionit lejohet shprehimisht diku tjetër në këtë Marrëveshje, secila Palë:

43.1.1. Do të trajtojë Informacionin Konfidencial të Palës tjetër si konfidencial dhe ruajë atë në mënyrën e duhur; dhe

43.1.2 Nuk do t'i zbulojë Informacionin Konfidencial të Palës tjetër ndonjë personi tjetër pa miratimin paraprak me shkrim të zotëruesit.

43.2 Dispozita 43.1 nuk do të zbatohet në shkallën që:

43.2.1 Ky informacion ka qënë në zotërim të Palës që bën zbulimin pa detyrimin e konfidencialitetit para zbulimit të tij nga zotëruesi i informacionit;

43.2.2 Ky informacion ishte përftuar nga një palë e tretë pa detyrimin e konfidencialitetit;

43.2.3 Ky informacion ka qënë për përdorim publik në kohën e zbulimit ndryshe nga shkelja e kësaj Marrëveshjeje; ose

43.2.4 Është zhvilluar në mënyrë të pavarur, pa akses në Informacionin Konfidencial të Palës tjetër.

43.2.5 Një informacion i tillë është i detyrueshëm për tu nxjerrë sipas ligjit.

43.3 Koncesioneri mund t'i zbulojë Informacionin Konfidencial të Autoritetit vetëm Personelit të Koncesionerit që është i përfshirë drejtpërdrejt në sigurimin e Shërbimeve dhe që ka nevojë të dijë informacionin dhe do të sigurojë që ky Personel i Koncesionerit të ndërgjegjësohet dhe të përmbushë këto detyrime në lidhje me konfidencialitetin.

43.4 Koncesioneri nuk do të përdorë Informacion Konfidencial të Autoritetit dhe do të sigurojë që Personeli i Koncesionerit të mos përdorë Informacion Konfidencial të Autoritetit, të marrë për qëllime të ndryshme nga ato të kësaj Marrëveshjeje.

43.5 Koncesioneri ndërmerr (përveçse kur mund të kërkohet nga Ligji ose me qëllim udhëzimin e konsulentëve profesionistë në lidhje me këtë Marrëveshje) të mos:

43.5.1 Zbulojë ose lejojë zbulimin e ndonjë hollësie të kësaj Marrëveshjeje për median e lajmeve ose ndonjë pale të tretë përveç Nënkontraktorëve;

43.5.2 Përdorë emrin e Autoritetit dhe ose markën në ndonjë promocion ose marketing ose shpallje të urdhrave, pa miratimin paraprak me shkrim të Autoritetit.

43.6 Me kërkesën me shkrim të Autoritetit, Koncesioneri do të sigurojë që ata anëtarë të Personelit të Koncesionerit të identifikuar në një njoftim me shkrim nga Autoriteti, të nënshkruajnë një marrëveshje konfidencialiteti para fillimit të ndonjë pune në përputhje me këtë Marrëveshje.

43.7 Asgjë në këtë Marrëveshje nuk do e pengojë Autoritetin të zbulojë nga Informacioni Konfidencial i Koncesionerit:

43.7.1 Ndaj cilitdo enti qeveritar. Të gjitha entet qeveritare që marrin këtë Informacion Konfidencial do të kenë të drejtë t'ia japin më tej Informacionin Konfidencial departamenteve të tjera qeveritare, mbi bazën që informacioni të jetë konfidencial dhe të mos i zbulohet një pale të tretë që nuk është pjesë e departamentit qeveritar ose e një Autoriteti.

43.7.2 Mbi bazën e "nevojës për njohuri" nga konsulenti, kontraktori ose ndonjë person tjetër të angazhuar nga Autoriteti me kusht që një person i tillë të bjerë dakord që ta ruajë këtë informacion si konfidencial;

43.7.3 Mbi bazën e "nevojës për njohuri", për qëllim të shqyrtimit dhe vërtetimit të llogarive të Autoritetit.

43.8 Autoriteti do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të siguruar që çdo departament qeveritar, punonjës, palë e tretë ose Nënkontraktor të cilit i jepet Informacioni Konfidencial i Koncesionerit sipas Nenit 43.7 të ndërgjegjësohet për detyrimet e konfidencialitetit të Autoritetit.

43.9 Asgjë në këtë Neni 43 nuk do të pengojë asnjë Palë nga përdorimi i ndonjë teknike, ideje ose ekspertize të fituar gjatë përmbushjes së Marrëveshjes gjatë aktivitetit të saj normal, në shkallën që ky përdorim nuk çon në zbulimin e Informacionit Konfidencial të Palës tjetër ose një shkelje të IPR.

44 Kufizimet në Përgjegjësi

44.1 Asnjë Palë nuk e kufizon përgjegjësinë e saj për:

44.1.1 Vdekjen ose plagosjen personale të shkaktuar nga neglizhenca e saj ose nga neglizhenca e punonjësve, agjentëve ose Nënkontraktorëve të saj (si të jetë e zbatueshme); ose

44.1.2 Mashtrimin nga ana e saj ose nga punonjësit e saj.

44.2 Kufijtë financiarë

Duke iu nënshtruar Nenit 42.1, përgjegjësia e plotë e Koncesionerit:

44.2.1 Për të gjithë humbjen ose dëmin në Mjedise, pronë ose asete (duke përfshirë infrastrukturën teknike, asetet ose pajisjet por duke përjashtuar çdo humbje ose dëm të të Dhënave të Autoritetit ose ndonjë të dhëne tjetër) të Autoritetit të shkaktuar nga Pzotësia e Koncesionerit, në asnjë.rast nuk do të tejkalojë shumat e parashikuara në Programin 7;

44.2.2 në lidhje me Kreditë e Shërbimeve, Pagesat e Vonuara dhe humbja e të Dhënave të Autoritetit do të kufizohen në total për të gjithë Periudhën e Koncesionit për një shumë maksimale prej 2.5 milon Euro;

44.2.3 në lidhje me të gjitha pretendimet, humbjet ose dëmet e tjera që lindin ose nga dëmi (duke përfshirë neglizhencën), shkelja e kontratës ose ndonjë mënyrë tjetër sipas ose në lidhje me këtë Marrëveshje, në asnjë rast nuk do të tejkalojë shumën 12 milion Euro.

44.3 Në bazë të klauzolave 44.1 dhe 44.4, asnjë Palë nuk do të jetë përgjegjëse ndaj palës tjetër për:

44.3.1 Çdo humbje ose dëm jo të drejtpërdrejtë të veçantë ose pasues; dhe/ose

44.3.2 Çdo humbje e fitimeve, xhiros, mundësive të biznesit ose dëmtimit të reputacionit (qoftë i drejtpërdrejtë ose jo).

44.4 Autoriteti mund të rikuperojë si humbje e drejtpërdrejtë:

44.4.1 Çdo kosto dhe shpenzim shtesë operacional dhe/ose administrativ që lind nga Pazotësia e Koncesionerit;

44.4.2 Çdo shpenzim ose tarifë e shpërdoruar, e bërë e panevojshme dhe/ose e shkaktuar nga Autoriteti që lind nga Mospagimi i Koncesionerit;

44.4.3 Çdo shpenzim që lind nga prishja ose humbja e ndonjë të Dhëne të Autoritetit;

44.4.4 Koston e mëtejshme të prokurimit të Shërbimeve të Zëvendësimit për pjesën që mbetet të Afatit.

44.5 Palët bien dakord shprehimisht që nëse ndonjë kufizim ose kusht në përmbajtje të kësaj dispozite ose i referuar shprehimisht në këtë Nen 44 (Kufizimet mbi përgjegjësinë) çmohet të jetë i pavlefshëm sipas ndonjë Ligji, do të konsiderohet i përjashtuar në atë shkallë dhe nëse ndonjë Palë është përgjegjëse për humbjen ose dëmin për të cilin është zbatuar ai kufizim ose kusht, ajo përgjegjësi do t'i nënshtrohet kufizimeve dhe kushteve të mbetura të përcaktuara në këtë Nen 44 (Kufizimet mbi përgjegjësinë).

44.6 Asgjë në këtë Nen 44 (Kufizimet mbi përgjegjësinë) nuk do të veprojë për të dobësuar ose cënuar detyrën e përgjithshme të një Pale për reduktimin e humbjes së saj.

45 Sigurimi

45.1 Në bazë të Nenit 45.2, Koncesioneri do të nxjerrë dhe mbajë ose do të sigurojë mbajtjen e Sigurimeve në përputhje me kushtet e Programit 7 (Sigurimi).

45.2 Nëse në një kohë të caktuar Koncesioneri nuk është në gjendje të ruajë ndonjë prej Sigurimeve, Koncesioneri do të kujdeset menjëherë që Garantuesi të pajisë Autoritetin me garancinë e barazvlefshme me anë një letre kredie.

46 Detyrimet për Burime, Licensë dhe Bashkëpunim të Koncesionerit

46.1 Koncesioneri:

46.1.1 Do të caktojë në çdo kohë burime të mjaftueshme për të realizuar Shërbimin në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje;

46.1.2 Do të marrë dhe ruajë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje të gjitha miratimet, licencat, dhe lejet (e ligjshme, rregullatore, kontraktuale apo të tjera) që mund të kërkohen dhe që janë të nevojshme për të mundësuar dhënien e Shërbimit; si dhe

46.1.3 Do t'i ofrojë furnitorëve të tjerë të Autoritetit për të cilët njoftohet Koncesioneri, bashkëpunimin dhe informacionin (përfshirë çdo dokumentacion) të nevojshëm, këshilla dhe asistencë në lidhje me Shërbimet dhe Sistemin me qëllim mundësimin e krijimit dhe mirëmbajtjes nga çdo person të ndërfaqeve teknike apo organizative të Shërbimeve dhe Sistemit dhe, me mbarimin e kësaj Marrëveshjeje për çfarëdo lloj arsyeje, mundësimin e kalimit në kohën e duhur të Shërbimeve (apo të çdo pjese të tyre) dhe Sistemit tek cilido Koncesioner Zëvendësues.

47 Garancitë

47.1 Autoriteti

Autoriteti deklaron dhe garanton se, që nga data e kësaj Marrëveshjeje dhe gjatë Periudhës së Koncesionit:

47.1.1 Ai ka fuqinë dhe autoritetin e plotë për të ekzekutuar, realizuar dhe përmbushur detyrimet nën këtë Marrëveshje dhe për të kryer transaksionet e parashikuar në të;

47.1.2 Kjo marrëveshje përbën detyrimin e tij ligjor, të vlefshëm dhe ligjërisht detyrues që parashikohet në përputhje me kushtet e saj;

47.1.3 Pasuritë / Asetet që lidhen me zbatimin e Koncesionit në pronësi të Autoritetit janë dhe do të mbeten të çliruara nga të drejtat e palëve të treta, gjatë të gjithë Periudhës së Koncesionit;

47.1.4 Do të mbrojë dhe nuk do të dëmtojë Koncesionerin nga të gjitha pretendimet e palëve të treta në lidhje me zotërimin paqësor (posedimin si pronë) të vendeve dhe aseteve të Koncesionit;

47.1.5 Ai ka marrë të gjitha autorizimet dhe lejet e nevojshme për të lidhur këtë Marrëveshje;

47.1.6 Ekzekutimi, realizimi dhe përmbushja e kësaj Marrëveshjeje nuk do të krijojë konflikte, nuk do të rezultojë në shkelje dhe nuk do të përbëjë kundërvajtje apo të përshpejtojë realizimin që kërkohet nga çfarëdo kushti i ligjeve në fuqi apo marrëveshjeve, konventave, dekreteve apo urdhrave tek të cilat ai është palë apo nga të cilat ai ose cilado pronë apo aset mund të ndikohen ose mbartin detyrim.

47.2 Koncesioneri

Koncesioneri deklaron dhe garanton tek Autoriteti se, që nga data e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje dhe gjatë Periudhës së Koncesionit:

Sagem Sécurité

47.2.1 Është e organizuar rregullisht dhe ekziston ligjërisht si shoqëri e ngritur sipas ligjeve të Francës;

47.2.2 Kjo marrëveshje përbën detyrimin e tij ligjor, të vlefshëm dhe ligjërisht detyrues që parashikohet në përputhje me kushtet e saj

47.2.3 Ka fuqinë dhe autoritetin e plotë për të ekzekutuar, realizuar dhe përmbushur detyrimet nën këtë Marrëveshje dhe për të kryer transaksionet e parashikuar në të;

47.2.4 Ka marrë të gjitha autorizimet e nevojshme të Shoqërisë dhe ka ndërmarrë veprime të tjera sipas ligjeve në fuqi si dhe dokumentet ligjore për të miratuar ekzekutimin, realizimin dhe përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje.

47.2.5 Ka pozitën dhe kapacitetin financiar për të ndërmarrë Koncesionin;

47.2.6 Asnjë deklarim apo garanci nga Sagem që përfshihen këtu apo në dokumente të tjera të dorëzuara nga ai tek Autoriteti apo në Institucione të tjera Shtetërore në lidhje me Koncesionin nuk përmbajnë apo nuk do të përmbajnë deklarata të pavërteta të fakteve materiale ose nuk anashkalon apo nuk do të anashkalojë deklarimin e fakteve materiale që janë të nevojshme për të deklaruar apo garantuar vërtetësinë;

47.2.7 Do të përmbushë detyrimet e tij me zellin e duhur profesional;

47.2.8 Nuk është e falimentuar dhe është në përputhje të plotë me ligjet në fuqi dhe dispozitat e kësaj Marrëveshjeje;

47.2.9 Zbatimi i Koncesionit është në përputhje të plotë me Klauzolat e Asociimit të Sagem Sécurité apo me ligjet në fuqi apo me marrëveshjet, konventat, dekretet apo urdhrat tek të cilat ai është palë apo nga të cilat ai ose cilado pronë apo aset mund të ndikohen ose mbartin detyrim;

Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve

47.2.10 Është e organizuar rregullisht dhe ekziston ligjërisht si shoqëri jo-fitimprurëse e ngritur sipas ligjeve të Shtetit Delaware, Shtetet e Bashkuara të Amerikës;

47.2.11 Kjo marrëveshje përbën detyrimin e tij ligjor, të vlefshëm dhe ligjërisht detyrues që parashikohet në përputhje me kushtet e saj;

47.2.12 Ka fuqinë dhe autoritetin e plotë për të ekzekutuar, realizuar dhe përmbushur detyrimet nën këtë Marrëveshje dhe për të kryer transaksionet e parashikuar në të;

47.2.13 Ka marrë të gjitha autorizimet e nevojshme të Shoqërisë dhe ka ndërmarrë veprime të tjera sipas ligjeve në fuqi si dhe dokumentet ligjore për të miratuar ekzekutimin, realizimin dhe përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje;

47.2.14 Ka pozitën dhe kapacitetin financiar për të ndërmarrë Koncesionin;

47.2.15 Asnjë deklarim apo garanci nga Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve që përfshihen këtu apo në dokumente të tjera të dorëzuara nga ai tek Autoriteti apo në Institucione të tjera Shtetërore në lidhje me Koncesionin nuk përmbajnë apo nuk do të përmbajnë deklarata të pavërteta të fakteve materiale ose nuk anashkalon apo nuk do të anashkalojë deklarimin e fakteve materiale që janë të nevojshme për të deklaruar apo garantuar vërtetësinë;

47.2.16 Do të përmbushë detyrimet e tij me zellin e duhur profesional dhe në përputhje me standartet kombëtare dhe ndërkombëtare;

47.2.17 Nuk është e falimentuar dhe është në përputhje të plotë me ligjet në fuqi dhe dispozitat e kësaj Marrëveshjeje;

47.2.18 Zbatimi i Koncesionit është në përputhje të plotë me Dispozitat e Asociimit të Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve apo me ligjet në fuqi apo me marrëveshjet, konventat, dekretet apo urdhrat tek të cilat ai është palë apo nga të cilat ai ose cilado pronë apo aset mund të ndikohen ose mbartin detyrim;

47.3 Koncesioneri garanton, deklaron dhe ndërmerr për kohëzgjatjen e Afatit se:

47.3.1 I gjithë personeli i përdorur për të kryer Shërbimet do të shqyrtohet në përputhje me Praktikat e Mira të Industrisë, Politikën e Sigurimit si dhe sipas Standarteve;

47.3.2 Ka dhe do të vazhdojë të ruajë të gjitha miratimet rregullatore (nëse ka), lejet, liçencat, pëlqimet, autorizimet nga Entet Rregullatore, të nevojshme për të përmbushur detyrimet e Koncesionerit sipas kësaj Marrëveshjeje;

47.3.3 Ka dhe do të vazhdojë të ketë të gjitha të drejtat e nevojshme tek dhe për Programin Kompjuterik të Koncesionerit apo Programe Kompjuterike të Palëve të Treta dhe/ose të Drejtat e Pronësisë Intelektuale të Sfondit të Koncesionerit, apo materiale të tjera që janë bërë të disponueshme nga Koncesioneri dhe/ose nënkontraktorët për Autoritetin, të cilat janë të nevojshme për të përmbushur detyrimet e Koncesionerit sipas kësaj Marrëveshjeje;

47.3.4 Në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje, të gjitha programet kompjuterike (software) e përdorur apo në emër të Koncesionerit:

47.2.1.1 Do të jetë version aktualisht në mbështetje të atij Programi kompjuterik; dhe

47.2.1.2 Do të funksionojë në të gjitha aspektet materiale në përputhje me përcaktimet e hollësishme të tij;

47.3.5 Deri në datën e hyrjes në fuqi, të gjitha deklaratat dhe thëniet në Propozimin e Koncesionerit janë, sipas njohurive, informacioneve dhe sigurisë së tij, të vërteta dhe të sakta dhe se ai do të njoftojë Autoritetin për ndonjë fakt, çështje apo rrethanë që do të mësojë se deklarata apo thënie të tilla mund të jenë të pavërteta apo mashtruese;

47.3.6 Rikthimi do të përmbajë të gjitha informacionin dhe shpjegimet që duhen në lidhje me largimin e Koncesionerit dhe për punonjësit me kualifikimin e duhur të Autoritetit ose për Koncesionerin e Zëvendësimit që të jetë në gjendje të përdorë Softuerin dhe të marrë shërbimet si dhe të kryejë shërbimet e zëvendësimit gjatë mbarimit apo skadimit;

Sistemi i Koncesionerit dhe asetet e përdorura në kryerjen e Shërbimeve të jenë të lira nga të gjitha barrët;

47.3.7 Të gjitha borxhet, përgjegjësitë dhe detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje duhet të përmbushen me aftësi, kujdes dhe zell nga një personel profesionist me trainimin, kualifikimin dhe përvojën e duhur;

47.3.8 Në datën e kësaj Marrëveshjeje, Koncesioneri nuk është subjekt i asnjë rrethane të Falimentimit dhe ka pozitën dhe kapacitetin financiar për të realizuar Projektin;

47.3.9 Ai do të operojë dhe mirëmbajë të gjitha mjediset e Projektit, përfshirë mjediset dhe ndërtesat e Autoritetit dhe nëse kërkohet duhet të modifikojë, riparojë apo të përmirësojë këto mjedise për të përmbushur të gjitha kërkesat e përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe në përputhje me Praktikat e Mira të Industrisë si dhe ligjet në fuqi.

48 Siguria

48.1 Koncesioneri do të përmbushë dhe do të autorizojë përmbushjen nga Personeli i Koncesionerit të Politikës së Sigurisë.

48.2 Autoriteti duhet të njoftojë Koncesionerin për çdo ndryshim apo ndryshime të propozuara në Politikën e Sigurisë.

48.3 Nëse Koncesioneri beson se ndryshimi apo ndryshimi i propozuar në Politikën e Sigurisë do të ketë ndikim material apo kosto të pashmangshme tek Shërbimet, ai mund të paraqesë një Kërkesë për Ndryshim. Në këtë rast, Koncesioneri duhet të mbështesë kërkesën e tij duke dhënë fakte të shkakut të rritjes së kostove dhe hapat që ai ka ndërmarrë për të zbutur (zvogëluar) këto kosto. Çdo ndryshim në Tarifa duhet më pas të miratohen në përputhje me Procedurën e Kontrollit të Ndryshimit.

48.4 Deri dhe/ose përveçse në rast të miratimit të një ndryshimi në Tarifa nga Autoriteti sipas Nenit 3.3, Koncesioneri duhet të vazhdojë të kryejë Shërbimet në përputhje me detyrimet e tij ekzistuese.

48.5 Siguria e Personelit

48.5.1 Koncesioneri do të veprojë në përputhje me Procedurat e Shqyrtimit të Personelit siç përcaktohen në Programet 2 dhe 3 në lidhje me të gjithë personelin e Koncesionerit të punësuar apo të angazhuar në kryerjen e Shërbimeve. Koncesioneri konfirmon se i gjithë personeli i Koncesionerit i punësuar apo angazhuar nga Koncesioneri në Datën e Hyrjes së Fuqi u shqyrtuan dhe u rekrutuan mbi baza që janë të barasvlershme apo jo më pak strikte se Procedurat e Shqyrtimit të Personelit.

48.5.2 Koncesioneri do të realizojë trainime të vazhdueshme për të gjithë personelin e Koncesionerit, të cilët janë punësuar apo angazhuar në kryerjen e Shërbimeve në përputhje me Politikën e Sigurisë.

48.6 Programe kompjuterike të dëmshme

48.6.1 Si detyrim i vazhdueshëm gjatë gjithë kohëzgjatjes, Koncesioneri do të përdorë versionet më të fundit të programeve anti-virus që disponohen nga prodhues të njohur të industrisë informatike për të kontrolluar dhe fshirë çdo Program kompjuterik të Dëmshëm nga Sistemi.

48.6.2 Pavarësisht Nenit 48.6.1, nëse evidentohet një Program kompjuterik i Dëmshëm, Palët do të bashkëpunojnë për të zvogëluar efektin e Programit kompjuterik të Dëmshëm dhe, veçanërisht nëse Program kompjuterik i Dëmshëm shkakton humbje të efektivitetit të punës apo humbje ose dëmtim të të dhënave të Autoriteti, do të ndihmojnë njëri-tjetrin për të zbutur humbje të tilla dhe për të rikthyer në nivelin e dëshiruar funksionimin normal.

48.7 Çdo kosto që lind nga veprimet e palëve, të cilat ndërmerren sipas dispozitave të Nenit 3.8, do të mbulohen nga palët si më poshtë:

48.7.1 Nga Koncesioneri ku Programi kompjuterik i Dëmshëm lind nga Programi kompjuterik i Koncesionerit, nga Programi kompjuterik i Palëve të Treta apo të Dhënat e Autoritetit (ndërkohë që të Dhënat e Autoritetit ishin nën kontroll të Koncesionerit); dhe

48.7.2 Nga Autoriteti nëse Programi kompjuterik i Dëmshëm lind nga Programi kompjuterik i Autoritetit apo të Dhënat e Autoritetit (ndërkohë që të Dhënat e Autoritetit ishin nën kontroll të Autoritetit).

49 Të drejtat dhe Detyrimet e Koncesionerit

49.1 Të Drejtat e Koncesionerit

Përveç të drejtave që lindin nga dhënia e Koncesionit, Koncesioneri gëzon të drejtat e mëposhtme:

49.1.1 Të ushtrojë të gjitha të drejtat në lidhje me përdorimin dhe zotërimin e lirë të Ndërtesës Qëndrore të Personalizimit, Ndërtesës Mbështetëse (Back-up) dhe Ndërtesave Rajonale Administrative, me qëllimin dhe për kohëzgjatjen e Koncesionit dhe në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, pa kryer asnjë pagesë tek Autoritetit, me kusht të Ndërtesa Qëndrore e Personalizimit të mos ndryshohet, të lihet peng dhe të mos lidhet asnjë lloj marrëveshjeje në çfarëdo lloj forme me të tjerë për këto mjedise.

49.1.2 Të punësojë apo angazhojë punonjës, përfshirë Personelin Kyç, me qëllim zbatimin e Koncesionit si dhe të hartojë politikën e vetë të punësimit në përputhje me ligjet në fuqi dhe këtë Marrëveshje;

49.1.3 Të kryejë veprime të tjera që i konsideron të nevojshme për të përmbushur Marrëveshjen e Koncesionit, të përmbushë detyrimet e tij dhe të ushtrojë të drejtat e tij sipas kësaj Marrëveshjeje;

49.1.4 të negociojë për rinovimin e Periudhës së Koncesionit në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj Marrëveshje;

49.1.5 të zgjasë Periudhën e Koncesionit në përputhje me Nenin 3.3.2.

49.1.6 Të zëvendësojë çdo pajisje njësie kompjuterike, programi kompjuterik, materiale konsumi të renditura në Programin 3 (Zgjidhja e Koncesionerit) me pajisje të barasvlershme përsa i përket funksionimit.

49.2 Detyrime të Përgjithshme të Koncesionerit

49.2.1 Të zbatojë Koncesionin në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe Shtojcat e saj;

49.2.2 Përveç rasteve kur shprehet ndryshe në këtë Marrëveshje ose kur është rënë dakord ndryshe mes Palëve, Koncesioneri do të mbulojë kostot dhe shpenzimet që shoqërojnë përmbushjen e detyrimeve të tij në përputhje me këtë Marrëveshje dhe Shtojcat e saj;

49.2.3 Gjatë Periudhës së Koncesionit, Koncesioneri do të veprojë në përputhje me standartet vendore dhe ndërkombëtare dhe rekomandimet në fuqi në datën e

ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje përsa i përket tipareve të Dokumenteve të Identifikimit (ID) përfshirë këtu edhe standartet;

49.2.4 Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje dhe në Ligj, Koncesioneri do të aplikojë dhe paguajë, marrë dhe ruaje të gjitha autorizimet, lejet dhe licencat e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje;

49.2.5 Koncesioneri do të caktojë, mbikqyrë, monitorojë dhe kontrollojë aktivitetet e nënkontraktorit (sipas kontratave përkatëse që mund të jenë të nevojshme) në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe Shtojcat e saj;

49.2.6 Pas përfundimit të Periudhës së Koncesionit dhe në përputhje me dispozitat e Marrëveshjeje dhe Programit të Menaxhimit të Largimit (Daljes), të gjitha pasuritë e krijuar apo rindërtuar apo të zhvilluara posaçërisht ose të përdorura nga Koncesioneri dhe/ose punonjësit e tij dhe që i përkasin Koncesionerit gjatë Periudhës së Koncesionit dhe për qëllimin e zbatimit të Koncesionit, përfshirë sistemet softuer dhe harduer dhe të drejtat e pronësisë intelektuale, do t'i kalohen Autoritetit pa pagesë shpërblimit nga Autoriteti për Koncesionerin.

49.3 Detyrime të Posaçme të Koncesionerit

Koncesioneri është i detyruar:

49.3.1 Të krijojë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje Shoqërinë Koncesionere, e cila do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj realizimit të Koncesionit "Prodhimi dhe Shpërndarja e Kartave të Identitetit dhe Pasaportave Elektronike" në përputhje me kushtet dhe dispozitat e kësaj Marrëveshjeje;

49.3.2 Të paraqesë tek Autoriteti brenda afatit të përcaktuar në Programin 10 (Plani i Projektit) modelin dhe projektin përfundimtar për Kartat e identitetit dhe Pasaportat Elektronike;

49.3.3 Të rehabilitojë, ripajisë dhe operojë Ndërtesën Qëndrore të Personalizimit, Ndërtesën Mbështetëse (Backup) si dhe të rinovojë dhe vërë në veprim Zyrat e Aplikimit, në përputhje me kërkesat dhe afatet e përcaktuara në këtë Marrëveshje;

49.3.4 Të hartojë, vendosë, menaxhojë, mirëmbajë, operojë dhe mbikqyrë Sistemin gjatë Periudhës së Koncesionit në përputhje me kërkesat dhe afatet e parashikuara në këtë Marrëveshje;

49.3.5 Të sigurojë cilësi të lartë, besueshmëri dhe qëndrueshmëri të Sistemit gjatë periudhës së Koncesionit;

49.3.6 Të vërë në zbatim një sistem fleksibël, të adaptueshëm ndaj ndryshimeve legjislative dhe përmirësimeve të miratuara teknologjike në lidhje me dokumentet e identifikimit, duke iu nënshtruar Nenit 24 në lidhje me menaxhimin e ndryshimeve në Sistem;

49.3.7 Të hartojë një sistem me hapa të njëpasnjëshëm, të aftë për të përshtatur numrin e pritshëm të popullsisë që do të përdorë sistemin e Kartave të Identifikimit, duke iu nënshtruar Nenit 24 në lidhje me menaxhimin e ndryshimeve në Sistem;

49.3.8 Të trajnojë personelin e Koncesionerit dhe punonjësit e Autoritetit në përputhje me kërkesat e kësaj marrëveshjeje dhe Programin 3 (Zgjidhja e Koncesionerit);

49.3.9 Të sigurojë ruajtjen e fshehtësisë, sigurisë dhe integritetit të të Dhënave të ruajtura Biometrike gjatë procesit të transmetimit midis nën-sistemeve dhe Sistemit;

49.3.10 Duke iu nënshtruar kufizimeve të përcaktuara në këtë marrëveshje, të sigurojë se vetëm personat e miratuar nga të dy palët kanë akses në Ndërtesën Qëndrore të Personalizimit, Ndërtesën Rezervë dhe sipas përmbushjes së standarteve në fuqi për sigurinë të përcaktuara në ligjet e zbatueshme dhe në këtë Marrëveshje;

49.3.11 Të informojë Autoritetin në çfarëdo rrethane që mund të dëmtojë proçesin e zbatimit të Koncesionit;

49.3.12 Të raportojë çdo muaj tek Autoritetit në lidhje me përparimin e realizuar në zhvillimin e Koncesionit, siç përcaktohet në këtë Marrëveshje;

49.3.13 Të marrë të gjitha masat e duhura dhe të nevojshme me qëllim garantimin e kushteve të sigurisë në punë për punonjësit e tij si dhe të njohë legjislacionin që lidhet me parandalimin e dëmeve dhe fatkeqësive.

50 Përfundimi

50.1 Dispozita të përgjithshme

Autoritetit, në rast se nuk është parashikuar në këtë Marrëveshje, i jepet e drejta për të përfunduar këtë Marrëveshje kur:

50.1.1 Koncesioneri është në shkelje të detyrimeve të tij, sipas kësaj Marrëveshjeje dhe një shkelje e tillë, vazhdon pa ndërprerje, pas një periudhe prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga njoftimi i kësaj shkeljeje, me anë të një njoftimi me shkrim;

50.1.2 kur ka një kalim të aksioneve jo në pajtim me Nenin 27.2;

50.1.3 Një Pamundësi për të Paguar dëmin i ndodh Koncesionerit.

Koncesioneri, nëse nuk parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, ka të drejtë ta përfundojë këtë Marrëveshje kur Autoriteti është në shkelje materiale të detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshje dhe një shkelje e tillë, vazhdon pa ndërprerje, pas një periudhe prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga njoftimi i kësaj shkeljeje, me anë të një njoftimi me shkrim.

50.2 Përfundimi i Marrëveshjes për shkak të Forcës Madhore të Përfundimit

50.2.1 Nëse një Forcë Madhore e Përfundimit vazhdon ose është, me gjykimin e drejtë të Palëve, ka mundësi të vazhdojë për një periudhë me të gjatë se 6 muaj të njëpasnjëshëm, përveç dispozitave të nenit 41.5 (Pasoja e Ngjarjes së Forcës Madhore), secila Palë mund ti japë fund kësaj Marrëveshjeje, duke i dhënë një Njoftim Përfundimi Palës tjetër.

50.3 Njoftimi i Përfundimit

50.3.1 Secila nga Palët që i japin fund kësaj Marrëveshjeje në përputhje me Nenin 50, do ta bëjë këtë me anë të një Njoftimi paraprak me shkrim prej 30 ditësh, i cili i dërgohet Palës tjetër (Njoftim Përfundimi). Njoftim Përfundimi duhet të përmbajë:

(i) detajet e duhura duke nënvizuar Ngjarjen e Shkakut;

(ii) Datën e Përfundimit, e cila duhet të jetë jo më parë se 30 ditë nga data e Njoftimit të Përfundimit;

(iii) Përfundimi i Pagesës, përfshirë dhe hollësitë e llogaritjes nga kjo dhe;

(iv) çdo informacion tjetër të rëndësishëm.

51 Pasojat e Përfundimit

51.1 Sigurimi i vazhduar i Shërbimeve

Në vijim të Njoftimit të Përfundimit, për çfarëdolloj arsye, Koncesioneri, duhet të vazhdojë të jetë nën detyrimin për t'i pajisur me Shërbime, Nivelet e Shërbimit dhe të sigurojë se, nuk ka përkeqësim në Nivelet e Shërbimit, apo të standardeve të tjera të Shërbimeve, deri në datën e përfundimit.

51.2 Në rast të përfundimit apo të mbarimit, Koncesioneri duhet:

51.2.1 Të ndërpresë përdorimin e të Dhënave të Autoritetit:

51.2.2 Të jetë në përputhje me detyrimet që i përmban plani i daljes; dhe

51.2.3 Pas marrjes së njoftimit me shkrim, ti sigurojë akses gjatë orëve të punës, Autoritetit, punonjësve të tij, agjencive dhe nën-kontraktorëve dhe/ose Koncesionerëve Zëvendësues për një periudhë 12 mujore, pas mbarimit të afatit të përfundimit për:

51.2.1.1një informacion, në lidhje me Shërbimet, meqenëse ai mbetet në zotërim ose kontroll të Koncesionerit; dhe

51.2.1.2anëtarët e personelit të Koncesionerit, meqë janë të përfshirë në dizenjimin, zhvillimin dhe përgatitjen e Shërbimeve dhe që ende janë të punësuar nga Koncesioneri.

51.3 Mbarimi i afatit të përfundimit, apo të përfundimeve të tjera të kësaj Marrëveshjeje (sido që të ndodhë ajo), nuk duhet të cënojë të drejtat apo ligjshmërinë e çdonjërës prej palëve, as edhe hyrjen në fuqi apo vazhdimësinë e ndonjë dispozite në këtë Marrëveshje, e cila në mënyrë të qartë apo të nënkuptuar, ka si qëllim të hyjë në fuqi apo të vazhdojë të jetë në fuqi pas mbarimit të afatit të përfundimit, ose të Përfundimit të Pjesshëm, që përfshin pa kufizim dispozitat e nenit 23 (Kontrollet Financiare), 28 (Garancia dhe Mirëmbajtja), 31 (Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale), 32 (Licencat e Dhëna nga Koncesioneri), 37 (Mbrojtja e të Dhënave Personale), 43 (Konfidencialiteti), 42 (Dëmshpërblimi), 44 (Kufizimet për Përgjegjshmërinë), 51 (Pasojat e Përfundimit), 60 (Ndarja), 64 (Marrëveshja e Plotë), 63 (Të Drejtat e Palës së Tretë) dhe 66 (Ligji rregullues dhe Juridiksioni), duhet të veprojë edhe pas përfundimit apo mbarimit të kësaj Marrëveshjeje.

52 Menaxhimi i Daljes

52.1 Autoriteti dhe Koncesioneri, duhet të jenë në përputhje me kërkesat e Menaxhimit të Daljes, të parashtruara në këtë Marrëveshje dhe me çdo Plan të Daljes. Pavarësisht nga çdo dispozitë tjetër e kësaj Marrëveshjeje, Autoriteti duhet të ketë të drejtat e parashtruara në nenin 52.2:

52.1.1 Nëse ndodh një Paaftësi Paguese, të drejtat e Autoritetit, sipas nenit 52.2, do të jenë të ushtrueshme nga Autoriteti në çdo kohë, para likuidimit të Koncesionerit apo të ndonjë pasoje kur ndodhin këto ngjarje, përfshirë këtu dhe caktimin e personit për kryerjen e pagesave, marrësin, menaxherin apo administratorin;

52.1.2 Në rast përfundimi të kësaj Marrëveshjeje për ndonjë arsye ; dhe/ose

52.1.3 Kur mbaron afati i kësaj Marrëveshjeje.

52.2 Koncesioneri nuk duhet që, pa lejen e Autoritetit, të ngarkojë Sistemin në rastin kur mund të kërkohet leja e një pale të tretë, për ushtrimin e të drejtave nga Autoriteti, apo qe mund te kerkojë në njëfarë mënyre, kufizimin e ushtrimit nga Autoriteti i të drejtave të tij sipas kësaj Marrëveshje. Në funksion të nenit 52.2, "ngarkuar me barrë" duhet të përfshijë çdo interes apo barazi të çdo personi (përfshirë këtu të drejtën për të përfituar, marrë ose e drejta për zëvendësim) ose e drejta për hipotekë, kallëzim penal, peng, pengim për garanci pagese, ngarkim, sigurimi të interesit, marrëveshjet e tjera për sigurinë apo masat të cilat, në rastin e kundërt, kufizojnë aftësitë e Koncesionerit të përdorë dhe të bjerë në ujdi me artikujt e rëndësishëm të Sistemit.

53 Të drejtat për Ndërhyrje

53.1 Autoriteti mund të marrë një veprim, në përputhje me këtë nen, në rrethanat e mëposhtme:

53.1.1 Kur ka një Pazotësi që i jep të drejtë Autoritetit, të përfundojë, në përputhje me nenin 50 (Përfundimi);

53.1.2 Kur ka një Pazotësi nga ana e Koncesionerit, që është parandaluar fizikisht ose ka vonuar përmirësimin e Shërbimeve apo të ndonjë pjese të tyre dhe kjo Pazotësi nuk është rregulluar brenda 30 ditëve pas njoftimit me shkrim nga Autoriteti;

53.2 Veprimet që duhet të merren para ushtrimit të të drejtave të ndërhyrjes

Para se Autoriteti, të ushtrojë të drejtat e tij ashtu si duhet, në përputhje me këtë nen 53.2, ai duhet ti japë mundësinë Koncesionerit, për një afat prej jo më pak se 15 ditësh, t'i tregojë Autoritetit që, ai është ende i aftë për të siguruar Shërbime, në përputhje me kushtet e Marrëveshjes dhe/ose të rregullojë rrethanat, duke dhënë të drejtën për ndërhyrje, pa kërkesën për të ndërmarrë një veprim nga ana e Autoritetit.

53.3 Nëse Autoriteti, nuk është i kënaqur me parametrat e Koncesionerit, në vijim të nenit 53.2, Autoriteti mund:

53.3.1 Në rastin kur Autoriteti, e sheh të arsyeshme dhe të përshtatshme këtë, t'i kërkojë Koncesionerit me anë të një njoftimi me shkrim, të ndërmarrë hapat që Autoriteti i konsideron të nevojshme ose të përshtatshme për të lehtësuar dhe rregulluar gjendjen e punimeve dhe për ti dhënë të drejtën Autoritetit për të hedhur hapin e duhur;

53.3.2 Caktojë një person të punojë me Koncesionerin, për të përmirësuar të gjitha ose një pjesë të Shërbimeve (përfshirë këtu dhe ata nga ndonjë palë nën-kontraktuese); ose

53.3.3 Të ndërmarrë hapa që Autoriteti të vlerësojë si të përshtatshme përmirësimin e të gjithë ose të një pjese të Shërbimeve (përfshirë këtu dhe ata nga ndonjë palë nën-kontraktuese).

53.4 Koncesioneri, duhet të bashkëpunojë plotësisht dhe në mirëbesim me Autoritetin, ose me ndonjë person tjetër i cili është caktuar, në përputhje me nenin 53.3.2, si dhe duhet të miratojë çdo metodologji të përshtatshme, për të pajisur Shërbimet e rekomanduara nga Autoriteti ose këtë person.

53.5 Ushtrimi i të Drejtave për Ndërhyrje

Nëse Koncesioneri:

53.5.1 Nuk arrin të konfirmojë brenda 10 ditëve të fillimit të punimeve, një njoftim, në përputhje me nenin 53.3.1 ku të shprehet se ai është i gatshëm për t'iu bindur këtij njoftimi; ose

53.5.2 Nuk arrin të punojë me një person të caktuar në përputhje me nenin 53.3.2; ose

53.5.3 Nuk arrin të ndërmarrë hapat që atij i janë njoftuar nga Autoriteti në përputhje me nenin 53.3.2,

atëherë, Autoriteti, mund të veprojë, sipas nenit 53, si personalisht ashtu dhe nëpërmjet ndihmës së palëve të treta kontraktore, që sigurojnë se Koncesioneri mund të kërkojë ndonjë palë të tretë, në përputhje me parimin e konfidencialitetit, ashtu si do të veprohej në përputhje me nenin 43), (Konfidencialiteti).

53.6 Nëse Autoriteti, vepron në përputhje me nenin 0, Autoriteti, duhet ti lëshojë një Njoftim Ndërhyrje("Step-in Notice") ndaj Koncesionerit. Ky njoftim duhet të paraqesë si vijon:

53.6.1 Veprimin e Autoritetit që shpreh dëshirën për të marrë vëçanërisht kontrollin mbi Shërbimet;

53.6.2 Arsyen për, si dhe shkakun e marrjes së këtij veprimi;

53.6.3 Datën kur ai dëshiron qe ky veprim të fillojë;

53.6.4 Kohën kur ai mendon se është e nevojshme fillimi i këtij veprimi;

53.6.5 Nëse Autoriteti, do të kërkojë akses për të hyrë në godinat dhe/ose vendet e Koncesionerit; dhe

53.6.6 të bëjë praktikë, ndikimin mbi Koncesionerin dhe mbi detyrimet e tij për të pajisur Shërbimet gjatë periudhës që ndërmerret veprimi.

53.7 Në vijim të një Njoftimi Ndërhyrje (Step-in Notice), Autoriteti duhet:

53.7.1 Të marrë masa që parashtrohen në Njoftimin e Ndërhyrjes (Step-in Notice) dhe çdo veprim tjetër shtesë, nëse në mënyrë të arsyeshme mendon se kjo është e nevojshme për të arritur (së bashku, "Planin e Kërkuar ");

53.7.2 të mbajë evidenca të Planit të Kërkuar dhe të sigurojë informacion në lidhje me Planin që i kërkohet Koncesionerit;

53.7.3 të bashkëpunojë me Koncesionerin, me qëllim që ti mundësojë këtij të fundit, vazhdimin e përgatitjeve, për të pajisur çdo Shërbim, në lidhje me të cilin, Autoriteti të mos pretendojë të ketë kontrollin; dhe

53.7.4 të veprojë në mënyrë të arsyeshme për të ulur çmimin që, Koncesioneri mund të pësojë si rezultat i ushtrimit të të drejtave të Autoritetit në përputhje me këtë nen.

53.8 Meqenëse, Plani i Kërkuar vazhdon plotësisht, Koncesioneri nuk është i detyruar ti shërbejë plotësisht Shërbimeve, për sa kohë ato janë në varësi të Planit të Kërkuar;

53.9 Para se ndërpresë ushtrimin e të drejtave të tij, në përputhje me nenin 53.2, Autoriteti, duhet ti lëshojë një njoftim me shkrim **("Step-Out Notice")**, duke specifikuar:

53.9.1 Planin e Kërkuar që ai tashmë e ka marrë ; dhe

53.9.2 datën në të cilën Autoriteti, planifikon për të përfunduar Planin e Kërkuar ("Step-Out Date"), nëse Autoriteti është dakord me aftësinë e Koncesionerit për të filluar përgatitjet për Shërbimet dhe për planin e Koncesionerit, në përputhje me 53.10.

53.10 Koncesioneri duhet, të marrë njoftimin dhe jo më pak se 20 ditë para Datës së këtij njoftimi, të hartojë për miratim nga Autoriteti një draft plan ("Step-Out Plan")lidhur me rifillimin nga Koncesioneri i Shërbimeve, përfshirë këtu dhe çdo veprim që ai propozon për të siguruar.që Shërbimet plotësojnë kërkesat e kësaj Marrëveshjeje.

53.11 Nëse Autoriteti, nuk e miraton draftin e Planit të Daljes, Autoriteti duhet të informojë Koncesionerin, për arsyet e mosmiratimit të tij. Koncesioneri, më pas, duhet të rishikojë draftin, duke marrë parasysh këto arsye dhe t`ia paraqesë planin e rishikuar Autoritetit për miratim. Autoriteti nuk duhet të refuzojë miratimin e këtij drafti, nëse nuk është e nevojshme.

53.12 Koncesioneri duhet të mbajë shpenzimet e veta, lidhur me punimet e autorizuara nga Autoriteti, në përputhje me nenin 53.2.

54 Lidhja e Përmbushjes / performancës

54.1 Koncesioneri, me shpenzimet e tij, do t'i sigurojë Autoritetit një Lidhje Performance / të Përmbushjes nga një bankë serioze apo nga një shoqëri sigurimesh e miratuar nga Autoriteti për një shumë të barabartë me 10 milionë Euro thelbësisht në formën e përcaktuar në Programin 12 (Lidhja e Performancës / Përmbushjes) (shënim për Bankën: I nevojshëm përpara nënshkrimit të Marrëveshjes). Një Lidhje e tillë e Performancës / Përmbushjes do të mbetet e vlefshme dhe në fuqi gjatë gjithë Afatit.

54.2 Nëse Koncesioneri është në mospërmbushje të detyrimeve të tij sipas Nenit 54.1 dhe nuk e rregullon këtë brenda 60 ditësh pas marrjes së një njoftimi me shkrim nga Autoriteti, Autoriteti mund ta përfundojë këtë Marrëveshje, pa njoftim të mëtejshëm ndaj Koncesionerit.

54.3 Autoriteti do të lëshojë Lidhjen e Performancës / Përmbushjes për Koncesionerin pas kalimit të një periudhe prej 30 ditësh që nga data e mbarimit apo kalimit të kësaj Marrëveshjes me kusht që Koncesioneri të mos jetë në kushtet e mospërmbushjes së detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshje.

54.4 Formulari i Sigurimit të Kontratës do të zvogëlohet nga Koncesioneri në përputhje me formulën në vijim:

54.4.1.13 milion Euro brenda 30 ditësh nga lëshimi i parë i një dokumenti të vërtetë identifikimi (jo test) ndaj një Aplikanti.

54.4.1.2 3 milion Euro brenda 30 ditësh nga përvjetori i parë i Datës Efektive;

54.4.1.3 1 milion Euro brenda 30 ditësh nga përvjetori i dytë i Datës Efektive;

54.4.1.4 500000 Euro brenda 30 ditësh nga përvjetori i tretë i Datës Efektive;

Në kohën kur duhen edhe 30 ditë deri në përvjetorin e tretë të Datës Efektive, do të mbeten 2500000 Euro në fuqi për të garantuar performancën e Koncesionerit deri në fund të Periudhës së Koncesionit dhe nëse në këtë kohë shume e Lidhjes së Performancës/ Përmbushjes do të jetë më pak se 2500000 Euro, Koncesioneri do të

rimbushë Lidhjen e Performancës / Përmbushjes deri në një shumë të tillë brenda një periudhe prej 30 ditësh, në këtë rast të vetëm.

54.5 Në rastin kur Koncesioneri, duke qenë në kushtet e mospërmbushjes së detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshje pas njoftimit, Autoriteti do të ketë të drejtë, pa paragjykuar të drejtat dhe mjetet e tjera të tij të parashikuara këtu, që të kërkojë çdo shumë financiare sipas Lidhjes së Performancës / Përmbushjes të cilën Koncesioneri është përgjegjës që ta paguajë ndaj Autoritetit sipas kësaj Marrëveshje. Lidhja e Performancës / Përmbushjes nuk do të kërkohet nga Autoriteti në rastet kur ndodh Forca Madhore apo ngjarje të Pazotësisë apo Pamundësisë që prekin Autoritetin.

55 Caktimi

55.1 Përveçse për dispoizitat e Neneve 27 dhe 28 të kësaj Marrëveshje, Palët bien dakord se kjo Marrëveshje do t'i caktohet nga Koncesioneri Shoqërisë Koncesionere në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshje. Për këtë qëllim, mbi bazën e rregjistrimit të Shoqërisë Koncesionere në Regjistrin Tregtar që mbahet nga Qendra Kombëtare e Rregjistrimit, Koncesioneri do të njoftojë me shkrim në formë të shkruar Autoritetin Kontraktor.

55.2 Në lidhje me një gjë të tillë, Palët bien dakord se të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lidhura me këtë Marrëveshje, përveçse për dispoizitat e Neneve 27 dhe 28 të kësaj Marrëveshje, do të quhen vetvetiu si të caktuara nga Koncesioneri për Shoqërinë Koncesionere duke filluar që nga data e regjistrimit të Shoqërisë Koncesionere në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit dhe në vazhdim të një caktimi të tillë, anëtarët e Koncesionerit nuk do të kenë më të drejta dhe detyrime në lidhje me Koncesionin, përveçse për dispoizitat e Neneve 27 dhe 28 të kësaj Marrëveshje.

55.3 Përveçse se për rastin e sipërpërmendur, Palët nuk do të kenë të drejtë të caktojnë apo transferojnë këtë Marrëveshje apo cilatdo të drejta e detyrime, që rrjedhin nga apo në vijim të kësaj Marrëveshje apo çfarëdo përfitimi apo interesi pa pëlqimin paraprak të Palës tjetër.

56 Çlirimi dhe rregullimet kumulative

56.1 Të drejtat dhe rregullimet e siguruar nga kjo Marrëveshje mund të hiqen vetëm me shkrim nga Përfaqësuesi përkatës në një mënyrë që deklaron shprehimisht se synohet çlirimi dhe se një çlirim i tillë do të jetë në veprim vetëm në lidhje me rrethanat e pëcaktuara me hollësi e të referuara aty.

56.2 Përveçse kur një e drejtë apo rregullim i Autoritetit është e shprehur se është një e drejtë apo rregullim ekskluziv / përjashtimor, ushtrimi i saj nga Autoriteti është pa paragjykim ndaj të drejtave dhe rregullimeve të tjera të Autoritetit. Çdo mosarritje apo dështim për të ushtruar një të drejtë apo rregullim nga secila Palë nuk do të përbëjë një çlirim nga ajo e drejtë apo rregullim apo nga çfarëdo të drejtash ose rregullimesh të tjera.

56.3 Të drejtat dhe rregullimet e siguruar nga kjo Marrëveshje janë kumulative dhe përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, nuk janë ekskluzive / përjashtimore ndaj cilësdo të drejtë apo rregullim të parashikuar në ligj apo parashikuar ndryshe në këtë Marrëveshje.

57 Marrëveshja e Palëve

Asgjë në këtë marrëveshje nuk ka për qëllim që të krijojë një ortakëri apo një marrëdhënie ligjore të çfarëdo lloji që mund të shtonte përgjegjësi mbi njërën Palë për veprimin apo mosveprimin e Palës tjetër apo që të autorizonte secilën nga Palët që të veprojë si agjente për Palën tjetër. Asnjëra nga palët nuk do të ketë Autoritetin që të bëjë përfaqësime apo të veprojë në emër të Palës tjetër apo të angazhojë palën tjetër në çfarëdo mënyrë.

58 Parandalimi i korrupsionit

58.1 Konçesioneri:

58.1.1 nuk do t'i ofrojë apo të bjerë dakord ti japë cilitdo person që punon apo që është angazhuar nga Autoriteti apo cilido organ tjetër i qeverisë shqiptare çfarëdo dhurate apo gjëje të ngjashme e cila mund të shërbejë si shtysë apo si një shpërblim për çfarëdo veprimi apo mosveprimi në lidhje me këtë Marrëveshje, ose me çdo marrëveshje tjetër ndërmjet Konçesioneri dhe Autoritetit ose cilitdo organ të qeverisë shqiptare, duke përfshirë këtu dhënien e kësaj kontrate ndaj Konçesionerit dhe cilësdo nga të drejtat dhe detyrimet që përmbahen në të; dhe as

58.1.2 nuk do të futet në këtë Marrëveshje nëse ka njohuri se, në lidhje me të, çfarëdo shume në para është paguar apo do t'i paguhet cilitdo person që punon për apo është i përfshirë nga Autoriteti apo cilido organ tjetër i qeverisë shqiptare apo për Konçesionerin, apo se një marrëveshje është arritur për këtë qëllim, përveçse kur hollësi të një marrëveshje të tillë janë bërë të njohura me shkrim për Autoritetin përpara zbatimit të kësaj Marrëveshje.

58.2 Nëse Konçesioneri (duke përfshirë këtu cilindo punonjës të Konçesionerit, nën – kontraktor apo agjent të tij, në të gjitha rastet nëse vepron apo jo me dijeninë e Konçesionerit) shkel Nenin 58.1, Autoriteti mund të përfundojë këtë Marrëveshje me anë të njoftimit me shkrim me efekt të menjëhershëm.

58.3 Çdo përfundim sipas Nenit 58.2 nuk do të paragjykojë asnjë nga të drejtat ose rregullimet e cila tashmë është krijuar apo krijohet në vazhdim për Autoritetin.

58.4 Pavarësisht nga Neni 28 (Konfliktet), çdo konflikt në lidhje me:

58.4.1. interpretimin e dispozitave nga 58.1 deri në 58.3; ose

58.4.2 shumën apo vlerën e cilësdo dhuratë, gjë të ngjashme apo përqindje,

do të përcaktohet nga Autoriteti dhe vendimi do të jetë përfundimtar dhe përmbyllës.

59 Publiciteti dhe markimi

59.1 Konçesioneri nuk do të bëjë asnjë deklaratë për shtyp apo ta publikojë këtë Marrëveshje apo përmbajtjes e saj në asnjë mënyrë pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit, pëlqimi i të cilit nuk do të refuzohet apo vonohet paarsyeshmërisht.

59.2 Secila Palë i njeh Palës tjetër se asgjë në këtë Marrëveshje, qoftë në mënyrë të shprehur apo në mënyrë të nënkuptuar përbën një miratim për cilindo nga produktet apo shërbimet e Palës tjetër (duke përfshirë këtu Sistemin) dhe secila Palë bie dakord që të mos sillet në një mënyrë të tillë që nënkupton apo shpreh një përqafim apo miratim të tillë.

60 Ndarja

Nëse cilado nga dispozitat e kësaj Marrëveshje vlerësohet si e pavlefshme, e paligjshme apo e pazbatueshme për çfarëdo arsye dhe nga cilado gjykatë apo juridiksion kompetent, një dispozitë e tillë do të ndahet pa sjellë pasoja për dispozitat që mbeten. Nëse një dispozitë e kësaj Marrëveshje që është themelore për përmbushjen e qëllimit të kësaj Marrëveshje gjykohet se është e pavlefshme në çfarëdo shtrirje, Koncesioneri dhe Autoriteti do të fillojnë menjëherë negociatat në mirëbesim për ta rregulluar këtë pavlefshmëri.

61 Sigurime të mëtejshme

Secila Palë merr përsipër me kërkesën e Palës tjetër dhe me shpenzimet e Palës që kërkon që të kryejë të gjitha veprimet dhe të zbatojë të gjitha dokumentat që mund të jenë të nevojshme për ti dhënë fuqi kuptimit të kësaj Marrëveshje.

62 Marrëveshja si një e tërë

62.1 Kjo Marrëveshje, së bashku me dokumentat të cilave i bëhet referim në të, përbën Marrëveshjen si një e tërë dhe mirëkuptimin e Palëve në lidhje me çështjet e trajtuara në të dhe sundon mbi, zhvlerëson dhe shfuqizon çdo marrëveshje të mëparshme ndërmjet Palëve në lidhje me çështje të tilla pavarësisht nga termat e cilitdo rregullim apo cilësdo marrëveshje të mëparshme që kanë shprehur se nuk do të përfundojnë.

62.2 Secila nga palët njeh dhe bie dakord se me hyrjen në këtë Marrëveshje dhe në dokumentat e referuar në të, ajo nuk mbështetet në – e si rrjedhim nuk do të përfitojë asnjë dëmshpërblim në lidhje me këtë, çfarëdo deklarate, përfaqësimi, garancie apo detyrimi të marrë përsipër (qoftë e bërë nga neglizhenca apo pa faj) të ndryshme nga sa është thënë në mënyrë të shprehur në këtë Marrëveshje. Rregullimi i vetëm i mundshëm për secilën palë në këtë Marrëveshje në lidhje me deklarime, përfaqësime, garanci apo kuptime të tilla do të jetë për raste të shkeljes së kontratës sipas termave të kësaj Marrëveshje

62.3 Asgjë në këtë Nen **Error! Reference source not found.** nuk do të veprojë për përjashtuar çdo lloj përgjegjësie me bazë mashtrimin.

63 Të drejtat e Palëve të Treta

63.1 Duke iu dispozitave të Nenit 43.7 (Konfidencialiteti), një person që nuk është palë në këtë Marrëveshje nuk ka të drejtë të zbatojë asnjë nga termat e kësaj Marrëveshje por kjo nuk prek çfarëdo të drejte apo rregullimi të çdo personi i cili ekziston apo është bërë i disponueshëm në vijim të një Akti të ndryshëm nga ky.

63.2 Çfarëdo të drejtash të krijuara sipas Nenit 63 mund të ndryshohen apo përfundohen nga palët pa pëlqimin e përfituesve të palëve të treta.

64 Njoftimet

64.1 Cilatdo Njoftime të dhëna sipas apo në lidhje më këtë Marrëveshje do të jenë më shkrim, të nënshkruara nga apo në emër të Palës që e bën njoftimin dhe do të njoftohet përmes dërgimit personalisht apo dërgimit të regjistruar të parapaguar apo postë të rregjistruar ose me faks në adresën dhe në vëmendjen e Palës përkatëse për këtë qëllim apo në atë adresë që Pala mund të ketë përcaktuar në përputhje me këtë Nen. Njoftimet nuk do të dërgohen me postë elektronike (e-mail).

64.2 Çdo Kërkesë për Ndryshim do të jetë me shkrim dhe e nënshkruar.

64.3 Do të quhet se një njoftim është marrë:

64.3.1 Nëse është dërguar personalisht, në kohën e dërgimit; dhe

64.3.2 Në rast të dërgimit të parapaguar me postë të klasit të parë, tre ditë pune që nga data e postimit.

64.4 Në të provuarit e shërbimit, do të jetë e mjaftueshme të provohet se zarfi që përmbante njoftimin u dërgua në adresën e Palës përkatëse në adresat e njoftuara paraprakisht për marrjen e njoftimeve (ose siç është njoftuar ndryshe nga ajo Palë) dhe u dërgua ose në atë adresë ose në ruajtjen e autoriteteve të postës si postë e parapaguar e klasit të parë, dërgim i rregjistruar, postë e rregjistruar apo letër e dërguar me postë ajrore.

65 Gjuha

Kjo Marrëveshje do të hartohet dhe nënshkruhet në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Në rast mospërputhjesh, kontradiktash, konfliktesh e pretendimesh ndërmjet tekstit në shqip të kësaj Marrëveshje dhe tekstit në anglisht të kësaj Marrëveshje, versioni në anglisht i kësaj Marrëveshje do të mbisundojë dhe do të jetë versioni i vetëm i detyrueshëm. Dokumentat e referuar apo dërguar në vijim të kësaj Marrëveshje do të jenë në gjuhët shqip dhe ose anglisht, si të kërkohet.

66 Ligji rregullues dhe Juridiksioni

66.1 Kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

66.2 Konfliktet do të zgjidhen së pari në pajtim me Proçedurën e Zgjidhjes së Konflikteve të përcaktuar në Programin 15 dhe nëse nuk mund të zgjidhen, ato do të zgjidhen përfundimisht me arbitrazh në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të ICC.

66.3 Numri i arbitrave do të jetë 3 (tre). Arbitrat do të emërohen në përputhje me Rregulat e Arbitrazhit të ICC. Vendi i arbitrazhit do të jetë në Gjenevë, Zvicër. Gjuha e arbitazhit do të jetë anglishtja. Kostot e arbitrazhit do të përcaktohen nga trupi i gjyqtarëve të arbitrazhit.

66.4 Duke iu nënshtruar zbatimit të proçedimeve të arbitrazhit, Palët heqin dorë në mënyrë të pakthyeshme e të pakushtëzuar nga e drejta e tyre për çfarëdo lloj forme ankimi, rishikimi apo rekursi përpara çdo gykate shtetërore apo autoriteti tjetër gjyqësor, për sa një çlirim i tillë mund të jetë bërë i vlefshëm.

NË PRANI të të cilëve kjo Marrëveshje është arritur siç duhet nga Palët.

NËNSHKRUAR për dhe në emër të **MINISTRISË SË BRENDSHME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Nënshkrimi: _____

Emri: **BUJAR NISHANI**

Pozicioni: Minister i Brendshem

NËNSHKRUAR për dhe në emër të **SAGEM SECURITE**

Nënshkrimi: _____

Emri: **JEAN-PAUL JAINSKY**

Pozicioni: Kryetare dhe Shef Ekzekutiv

NËNSHKRUAR për dhe në emër të **FONDIT SHQIPTARO – AMERIKAN TË NDËRMARRJEVE**

Nënshkrimi: _____

Emri: **ALEKSANDËR SARAPULI**

Pozicioni: Oficer Kryesore i Investimeve

NËNSHKRUAR për dhe në emër të **FONDIT SHQIPTARO – AMERIKAN TË NDËRMARRJEVE**

Nënshkrimi: _____

Emri: **MARTIN MATA**

Pozicioni: Oficer Kryesore i Investimeve